



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	936-1/25
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	30. 09. 2025
VUSHTRRI - VUÇITRN	

RAPORT

PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE INVESTUESE
PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2025

Shtator, 2025

Hyrje

Raporti është hartuar bazuar në planifikimin që është bërë për vitin 2025 dhe realizimi i projekteve dhe aktiviteteve të qeverisë komunale.

Në raport janë përfshirë të gjitha punët, projektet dhe aktivitetet e realizuara nga muaji janar deri në muajin qershor, nga secila drejtori dhe sektor i Komunës së Vushtrrisë.

Kanë vazhduar punët në realizimin e projekteve kapitale në të mirë të qytetarëve Vushtrrias. Punimet po vijnë edhe tani sipas planifikimit dhe shumica e projekteve të filluara do të përfundojnë deri në fund të këtij viti. Mirëpo, sikurse edhe vitin e kaluar edhe në këtë vit siç e dimë kemi vështirësi në kryerjen e projekteve kapitale për shkak të mungesës së mjeteve financiare të cilat i janë marrë komunës nga gjykata përkatësisht përmbaruesit, për punëtorë të arsimit dhe ata të shëndetësisë. Këto vështirësi na kanë përcjellë në të kaluarën janë duke na përcjellë edhe tani e sigurisht do të na përcjellin edhe vitin e ardhshëm.

Sa i përket angazhimeve të deritanishme në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve kemi punuar deri tani dhe jemi duke punuar në mbështetjen e tyre sidomos të të rinjve përmes formave të ndryshme.

Edhe gjatë këtij viti ka vazhduar përkrahja për nxënësit dhe studentët e komunës përmes bursave komunale, ku janë ndarë 85 bursa për studentët që studiojnë në Kosovë dhe atyre që studiojnë jashtë vendit. Gjithashtu, janë ndarë 10 bursa studimi për studentët vushtrrias në City Collage, Kampusi i University of York Europe në Selanik. Të rinjtë vushtrrias janë subvencionuar për ndjekjen e trajnimeve në fushën e zhvillimit softuerik në SPEEEX Education, si dhe për mësimin e gjuhëve të huaja, si gjermanisht dhe frëngjisht. Po ashtu, ka vazhduar subvencionimi i të rinjve dhe të rejave për aftësimin profesional në Diakonie Trainin Center. Mbështetje është ofruar edhe për nxënësit e Komunës së Vushtrrisë për pjesëmarrje në gara të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, janë shpërblyer nxënësit për sukseset e arritura dhe janë subvencionuar nxënësit me kushte të vështira financiare. Vëmendje e veçantë i është kushtuar subvencionimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Kemi vazhduar të mbështesim bujqit dhe fermerët vushtrrias përmes subvencioneve të ndryshme. Ka vazhduar subvencionimi me 50% për mbulimin e kostos së ujitjes së tokave bujqësore me ndërmarrjen "Ibër Lepenc". Janë subvencionuar fermerët me 5 cent për litër qumësht, me 5 euro për koshere të bletëve, me 5 euro për krerë dele dhe dhi, me 100 euro për krerë buallice.

Punët për pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve kanë vazhduar edhe gjatë këtij gjashtëmujori në të gjithë territorin e Komunës së Vushtrrisë, me qëllim që të shmangen rreziqet nga vërshimet duke shkatëruar dëme të mëdha në ekonominë familjare dhe toka bujqësore.

Administrata komunale, edhe gjatë këtij viti, ka ofruar shërbime shtesë për bashkatdhetarët tanë, duke krijuar sportele të dedikuara për diasporën dhe duke ofruar shërbime edhe ditëve të shtuna gjatë muajve korrik dhe gusht të këtij viti. Janë ofruar parkingje pa pagesë për mërgimtarët si dhe iu kemi organizuar pritje të veçanta ku kemi mbajtur programe muzikore në sheshin e qytetit për bashkatdhetarët tanë me

këngëtarë të njohur të muzikës shqiptare. E gjithë kjo është realizuar në kuadër të programit “Ditët e Diasporës” që organizohen tani e disa vite me radhë.

Komuna e Vushtrrisë është vlerësuar pozitivisht edhe sa i përket transparencës me qytetarë. Për të dytin vit me radhë, Instituti GAP e ka vlerësuar Komunën e Vushtrrisë 100% transparente në Indeksin e Transparencës Buxhetore. Edhe KDI në Transparimetrin Komunal e ka vlerësuar Komunën e Vushtrrisë me 95.83%, duke shënuar rritje në transparencë.

Të gjitha këto punë që i kemi bërë gjatë këtij gjashtëmujori dëshmojnë përkushtimin e Komunës së Vushtrrisë për zhvillim të qëndrueshëm, rritje të mirëqenies së qytetarëve ngritje të transparencës dhe llogaridhënies ndaj tyre.

Në vijim janë paraqitura punët që janë kryer në secilën drejtori veç e veç përkatësisht sektorë gjatë këtij gjashtëmujori.

Buxhet dhe Financa

Raporti është i bazuar në planin buxhetor dhe planin e rrjedhës së parasë publike për vitin 2025.

Planifikimi i buxhetit për periudhën Janar-Qershor 2025 është si në vijim

- Paga dhe mëditje..... 7,069,635.01€
- Mallra dhe shërbime..... 5,105,713.27€
- Shpenzime Komunale..... 298,449.9€
- Subvencione dhe transfero..... 1,328,337.7€
- Investime kapitale..... 4,812,532.72€

Totali i buxhetit për vitin 2024 është..... 18,614,668.60€

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar-Qershor 2025 është si në vijim

- Paga dhe mëditje..... 7,039,764.01€
- Mallra dhe shërbime..... 480,8692.12€
- Shpenzime Komunale..... 286,908.21€
- Subvencione dhe transfero..... 1,274,163.89€
- Investime kapitale..... 4,014,338.18€

Totali i buxhetit për vitin 2025 është..... 17,423,866.41€

Sqarim: Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti I realizuar për periudhën Janar-Qershor 2025.

Realizimi është 18,614,668.60.Realizimi I shpenzimeve është 17,423,866.41 euro,Realizimi 94%.

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Qershor 2025

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT									
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti I kaluar
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti I planifikuar për 2025	Buxheti I mbetur për 2025	Plani I reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2024
		4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11
		€	€	%	€	€	€	€	€
Finacimi nga huamarrjet	04			0%			0.00	0.00	
Granti Qeveritar	10	15,641,822.23	15,058,856.35	96%	24,740,352.13	9,681,495.78	0.00	24,740,352.13	12,154,117.14
Të hyrat vetanake	21	2,047,470.46	1,628,857.34	80%	3,525,467.00	1,896,609.66	0.00	3,525,467.00	1,025,336.67
Mjetet e bartura	22	897,972.29	728,755.12	81%	1007972.29	279,217.17	0.00	1,007,972.29	481,387.26
Donacionet e brendshme	31	3,623.23		0%	3,623.23	3,623.23	0.00	3,623.23	1,050.00
Donacionet e jashtme	32	23,780.39	7,397.60	31%	23,780.39	16,382.79	0.00	23,780.39	
TOTALI		18,614,668.60	17,423,866.41	94%	29,301,195.04	11,877,328.63	0.00	29,301,195.04	13,661,891.07

Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit sipas kategorive ekonomike është si vijon:

Granti Qeveritar për periudhën Janar-Qershor 2025,planifikimi është 18,614,668.60euro,Realizimi është 17,423,866.41eur,përqindja e realizimit 94%

Kategoria Të Hyrat vetanake fondi 21 për periudhën Janar-Qershor 2025,planifikimi është 2,047,470.46 euro,Realizimi I shpenzimit shuma 1,628,857.34euro. Realizimi 80%

Kategoria Të Hyrat vetanake fondi 22 për periudhën Janar-Qershor 2025,planifikimi është 897,972.29 euro,Realizimi I shpenzimit shuma 728,755.12euro. Realizimi 81%

Donacionet e brendeshme të planifikuara janë 3,623.23euro,të shpenzuara në këtë gjashtmuor nuk ka mbetet në gjashtmuorin e dytë për shpenzim.

Donacionet e jashtme të planifikuara janë 23,780.39euro,të realizuara janë 7,397.60euro apo shprehur në % realizimi 31% dhe

Totali I planifikimit në këto kategori ekonomike është 18,614,668.60.Realizimi I shpenzimeve është 17,423,866.41 euro,Realizimi 94%

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE

PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VJETORE				Viti i kaluar
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2023	Buxheti i mbetur për 2025	Plani i reviduar 2025	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2024
		€	€	%	€	€	€	€	€
Zyra e Kryetarit	160	275,533.18	262,062.18	95%	481,990.33	219,928.15	0.00	481,990.33	222,522.6
Administrata dhe personeli	163	383,452.81	359,978.93	94%	521,669.15	161,690.22	0.00	521,669.15	212,220.2
Inspektimet	166	76,014.78	69,459.78	91%	206,259.53	136,799.75	0.00	206,259.53	73,533.8
Prokurimi	167	21,881.17	20,881.17	95%	64,674.90	43,793.73	0.00	64,674.90	26,963.0
Zyra e Kuvendit Komunal	169	137,393.13	137,393.13	100%	318,582.43	181,189.30	0.00	318,582.43	128,287.8
Buxheti dhe financat	175	115,390.66	101,118.16	88%	236,735.72	135,617.56	0.00	236,735.72	95,652.8
Shërbimet publike, Mbrojtja civile dhe emergjenca	180	4,216,161.63	3,860,028.16	92%	5,231,875.09	1,371,846.93	0.00	5,231,875.09	2,427,494.8
Zyra lokale e komuniteteve	195	41,582.82	41,582.82	100%	101,689.33	60,106.51	0.00	101,689.33	28,485.7
Bujqësi, pylltari, zhvillimi rural	470	1,679,705.88	1,573,744.50	94%	2,319,289.17	745,544.67	0.00	2,319,289.17	492,782.3
Gjeodezi dhe Kadastër	650	65,524.19	64,024.19	98%	128,432.17	64,407.98	0.00	128,432.17	42,376.6
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	1,912,607.60	1,503,372.55	79%	2,496,319.27	992,946.72	0.00	2,496,319.27	1,183,380.7
Shëndetësia primare	730	2,016,633.99	1,946,339.95	97%	3,382,170.28	1,435,830.33	0.00	3,382,170.28	1,331,705.8
Shërbimet sociale rezidenciale		181,692.10	161,047.16	89%	351,492.04	190,444.88	0.00		133,173.8
Kulturë, rini, sport	850	467,627.84	431,875.12	92%	746,046.87	314,171.75	0.00	746,046.87	209,272.1
Arsimi	920	7,023,466.82	6,890,958.61	98%	12,713,968.76	5,823,010.15	0.00	12,713,968.76	7,054,039.3
TOTALI		18,614,668.60	17,423,866.41	94%	29,301,195.04	11,877,328.63	0.00	29,301,195.04	13,661,891.0

Sqarim: Sipas kategorive të shpenzimeve buxheti i planifikuar për periudhën Janar-Qershor 2025.

Planifikimi është 18,614,668.60. Realizimi i shpenzimeve është 17,423,866.41 euro, Realizimi 94%.

TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK

Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese			Vjetore				Viti i kaluar
		Buxheti i planifikuar për PR	Të hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhetit të realizuar për PR 6 = 5/4*100	Buxheti i planifikuar për 2025	Buxheti i mbetur për 2025	Plani i reviduar	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar 10 = 7-9	Te hyrat e realizuara ne periudhen e njejte 2024
		4	5	6	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11
Administrata dhe personeli	163	€	€	%	€	€	€	€	
Taksa administrative		60,000.00	23,149.00	39%	120,000.00	96,851.00	0.00	120,000.00	17,474.00
TOTAL		60,000.00	23,149.00	39%	120,000.00	96,851.00	0.00	120,000.00	17,474.00
Inspeksioni	166	€	€	%	€	€	€	€	€
Pranime teknike		4,000.00	7,535.00	188%	8,000.00	465.00	0.00	8,000.00	6,745.00
				0%		0.00	0.00	0.00	
Gjobat e inspeksionit		3,000.00	4,155.00	139%	6,000.00	1,845.00	0.00	6,000.00	2,900.00
TOTAL		7,000.00	11,690.00	167%	14,000.00	2,310.00	0.00	14,000.00	9,645.00
Buxheti dhe Financa	175	€	€	%	€	€	€	€	€
Taksat e firmave		7,500.00		0%	15,000.00	15,000.00	0.00	15,000.00	18,000.00
Tatimi në pronë		609,213.50	545,550.00	90%	1,218,427.00	672,877.00	0.00	1,218,427.00	370,249.01
TOTAL		616,713.50	545,550.00	88%	1,233,427.00	687,877.00	0.00	1,233,427.00	388,249.01
Arsimi	900	€	€	%	€	€	€	€	€
Shitja e prodhimave									
Participimi në çerdhje		35,000.00	78,853.00	225%	70,000.00	-8,853.00	0.00	70,000.00	62,724.00
Shkolla e Mesme Te...		10,000.00	26,082.00	261%	20,000.00	-6,082.00	0.00	20,000.00	16,630.00
Shkolla e Mesme Pro...		10,000.00	12,080.00	121%	20,000.00	7,920.00	0.00	20,000.00	10,515.00
TOTAL		55,000.00	117,015.00	213%	110,000.00	-7,015.00	0.00	110,000.00	89,869.00
Gjeodezi dhe Kadaster	650	€	€	%	€	€	€	€	€
Të nga Gjeodezia dhe...		50,000.00	37,600.80	75%	100,000.00	62,399.20	0.00	100,000.00	47,116.00
Qiraja nga objektet		26,500.00	15,410.00	58%	53,000.00	37,590.00	0.00	53,000.00	14,011.60
TOTAL		76,500.00	53,010.80	69%	153,000.00	99,989.20	0.00	153,000.00	61,127.60
Kulturë, rini dhe sport	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Palestra e sportit		250.00	325.00	130%	500.00	175.00	0.00	500.00	144.00
Biblioteka		250.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	
Shtëpia e Kulturës		250.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00	
TOTAL		750.00	325.00	43%	1,500.00	1,175.00	0.00	1,500.00	144.00
Shërbim e publike	180	€	€	%	€	€	€	€	5 Page
Ndalja e veturave ne...		1,500.00	3,852.00	257%	3,000.00	-852.00	0.00	3,000.00	1,121.00
Regjistrimi i automj...		75,000.00	87,190.00	116%	150,000.00	62,810.00	0.00	150,000.00	77,325.00
Taksat e mbeturinav...		423,000.00	315,432.35	75%	846,000.00	530,567.65	0.00	846,000.00	266,398.04

Ekonomi

Qendra Komunale e Biznesit funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash, si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare, kërkesa për ndryshim si dhe shërbime të tjera. Përveç sistemit ekzistues e- Regjistri i Biznesit aplikimi online tani e tutje që nga data 9 Qershor 2025, regjistrimi fillestar i shoqërive tregtare në Republikën e Kosovës do të mundësohet edhe përmes platformës elektronike e-Kosova.

Regjistrimi i shoqërive tregtare përmes platformës e-Kosova do të jetë plotësisht online. Aplikimi, miratimi i lëndës dhe lëshimi i certifikatës elektronike do të bëhet përmes kësaj platforme, pa pasur nevojë që aplikuesi të paraqitet në sportele të ARBK-së dhe të dorëzoj dokumentet në formë fizike.

Regjistrimi përmes sistemit ekzistues e-Regjistri i Biznesit do të vazhdojë të funksionojë në mënyrë pjesërisht elektronike, ku aplikimi dhe miratimi bëhen online, ndërsa certifikata mund të merret në Qendrën Komunale të Biznesit (QKB) në Komunë ku biznesi ushtron veprimtarinë ekonomike.

Përmes platformës e-Kosova, bizneset do të kenë mundësi të sigurojnë informatat dhe historinë e biznesit në mënyrë të plotë elektronike, pa pasur nevojë të paraqiten në QKB.

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të regjistruara gjatë periudhës 01.01. – 30.06.2024

CODE	VEPRIMTARITË EKONOMIKE	Bizneset prej 01.01-30.06.2025	%
1	2	3	4
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	13	11.3
B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	12	10.43
D	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë		
E	Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe te trjatisimit te mbeturinave		
F	Ndërtimtaria	18	15.65
15. G	Treg.me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	38	33.04
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	1	0.87
I	Transporti dhe magazimi Informimi dhe komunikimi	6	5.22
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit		
K	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	5	4.35
M	Arsimi	13	11.3

N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	9	7.84
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese		
P	Aktivitetet e ekonomive familjare		
	Gjithsej	115	100

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, si veprimtari dominuese ekonomike është tregtia me 33.04% apo me 38 biznese prej numrit të përgjithshëm, pastaj ndërtimtaria me 18 biznese apo 15.65 %, bujqësia me 11.3% apo me 131 biznese, etj

Në vazhdim do të japim pasqyrën tabelare të bizneseve të shuar, sipas veprimtarive ekonomike.

Kodi	VEPRIMTARIT EKONOMIK	Bizneset prej 01.01-30.06.2025	%
1	2		
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria dhe peshkimi	4	13.33
B	Minierat dhe guroret (Industria nxjerrëse)		
C	Industria përpunuese	3	10
D	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë		
E	Kanalizimi aktivitetet e menaxhimit dhe të trjatisimit të mbeturinave		
F	Ndërtimtaria	1	3.33
G	Treg. me shumicë dhe pakicë, riparimi i auto. dhe aparateve tjera të amvisërisë	11	36.7
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit		
I	Transporti dhe magazimi Informimi dhe komunikimi	2	6.66
J	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	1	3.33
K	Aktivitetet e patundshmërisë Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, shërbimet administrative dhe mbështetëse	1	3.33
M	Arsimi	3	10
N	Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	2	6.66
O	Artet, argëtimi dhe rekreacioni, aktivitetet tjera shërbyese		
P	Aktivitetet e ekonomive familjare	2	6.66
	Totali	30	100

Siç shifet nga të dhënat e tabelës edhe tek shuarjet dominon po ashtu tregtia me 11 biznese apo 36.7% dhe bujqësia me 13.33%etj.

Deri më 30.06.2024 janë kryer gjithsej këto shërbime:

<i>Nr.</i>	<i>Përshkrimi i aktivitetit</i>	<i>Nr.i llojit</i>	<i>Vërejtje</i>
1.	Biznese të reja (të regjistruara)	115	
2.	Shuarje të bizneseve	30	
3.	Ndërrime të logove të certifikatave	166	
4.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	81	
5.	Vërtetime	8	
	Gjithsej	400	

Përveç shërbimeve të lartshënuara, Sektori i Bizneseve ka kryer edhe lëndë të tjera si:

- Leje Pune për Auto Taxi -
- vazhdimin e lejeve për transportin autotaxi
- dhënia e certifikatave për kontribute - vitet e '90

Njëkohësisht, vërehet një interesim më i madh i pronarëve për të hapur biznese bujqësore (prodhuese) për shkak të subvencioneve që përfitojnë nga donatorët e ndryshëm, si dhe nga shoqatat e ndryshme joqeveritare.

Administratë

Objektiv i përgjithshëm strategjik i Drejtorisë ka qenë:

- Shërbime administrative kualitative, të qasshme, të bazuara në procedura administrative të arsyeshme dhe duke përdorur metodat e e-qeverisjes të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.
- Arkivimi elektronik dhe digjitalizimi i arkivit komunal,

Me qëllim të realizimit të këtyre objektivave dhe të funksionalizimit dhe digjitalizimit të administratës drejtoria për administratë të përgjithshme ka marr iniciativën e hartimit të tri(3) akte administrative që kanë të bëjnë me rregullimin e kësaj fushe:

- Listën e Shenjave të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre për Komunën e Vushtrrisë,
- Rregullat për Administrimin dhe Menaxhimin Zyrtar të Dokumenteve dhe Arkivimin e tyre dhe
- Udhëzuesin për informacione lidhur me shërbimet komunale,

Po ashtu gjatë këtij viti kemi zhvilluar dy takime pune me delegacionin e komunës së Vaxjës në projektin e përbashkët, **“Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit Komunal”**, projekt ky që do të zgjasë tri(3) vite me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në mes të dy delegacioneve të komunës së Vushtrrisë dhe të komunës së Vaxjës për avancimin dhe standartizimin e procedurave për funksionalizimin dhe digjitalizimin e arkivit komunal.

Zyra e Gjendjes Civile

Shërbimi i Gjendjes Civile gjatë periudhës janar-qershor ka ofruar të gjitha shërbimet që janë në kompetencë dhe që kryhen në këtë zyrë, trendi i ngritjes së efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive është në ngritje të vazhdueshme në këtë shërbim duke ju falënderuar angazhimit, profesionalizmit dhe punës që bëjnë zyrtarët e gjendjes civile dhe procesit të digjitalizimit të regjistrave dhe dokumenteve të gjendjes civile dhe harmonizimit të procedurave në ofrimin e shërbimeve dhe të lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile.

Përmes Regjistrat Qendror Elektronik të gjendjes Civile është bërë edhe ndërlidhja dhe harmonizimi i të dhënave personale të gjendjes civile për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës me platformën(elektronike) online E-Kosova, dhe që nga data 01 qershori i vitit 2022 është mundësuar pajisja(nxjerrja) e certifikatave të gjendjes civile nga kjo platformë pa pasur nevojë që të kontaktohen zyrat e gjendjes civile.

Zyra e gjendjes civile është duke e aplikuar edhe sistemin për menaxhimin e radhëve në zyrën e gjendjes civile i cili ka krijuar kushte shumë më të mira për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe zvogëlimin e parregullsive me rastin e pritjeve dhe marrjes së këtyre shërbimeve, po ashtu është krijuar edhe hapësira për pritje të qytetarëve gjatë marrjes së shërbimit në këtë zyrë.

Në vazhdim të ofrimit të shërbimeve më efikase dhe më efektive i kemi thjeshtëzuar procedurat e pagesave për marrjen e certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile, duke krijuar mundësinë që të gjitha pagesat për këto shërbime të kryhen në sportel të zyratari i njëjtë i cili e jep shërbimin.

Zyra e Gjendjes Civile ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë interes dhe nevojë për shërbime nga kjo zyrë dhe në vazhdim të këtij bashkëpunimi kemi pasur shumë takime, konferenca dhe trajnime me organizatat vendore dhe ndërkombëtare.

Në vazhdimësi jemi duke bashkëpunuar ngushtë edhe me Gjykatat e Kosovës, Agjencionin e sigurimeve pensionale të Kosovës dhe të shteteve të huaja dhe në çdo kërkesë i përgjigjemi në kohë, brenda ditës ose sipas afateve që i cakton gjykata, ngase kërkesat e gjykatës janë gjithmonë me urgjencë dhe si të tilla edhe i trajtojmë.

Ne si Zyre e Gjendjes civile kemi disa marrëveshje obligative të cilat janë të lidhura ndërmjet Agjencionit të Regjistrimit Civil(ARC-së) me Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtorinë për Bujqësi dhe zhvillim Rural dhe në vazhdimësi ju ofrojmë bashkëpunim dhe të dhëna sipas marrëveshjeve të lidhura dhe kërkesave që këto institucione apo drejtori i kanë.

Zyra e gjendjes civile i ka marrë të gjitha masat që të zbatohet vendimi i MAPL-se për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas të të gjitha fakteve të lindjes për komunitetin RAE, mirëpo në zyrën e gjendjes civile në komunën e Vushtrisë nuk është paraqitur asnjë rast i këtij komuniteti për regjistrim me vonesë dhe falas.

Punët e zyrës së gjendjes civile të paraqitur në formë tabelare

• vendime dhe shkresa të tjera:

1.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes	00
2.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	27
2.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	27
3.	Vendime për korrigjime të të dhënave personale në RQ	00
4.	Vendime për korrigjimin e të dhënave në regjistra fizik	26

5.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	22
6.	Dëshmi të vdekjes	135
7.	Lajmërime dhe ç'lajmërime të adresës së vendbanimit	5241
8.	Vendime për korrigjimin e Akteve të lindjes,	15
9.	Vendime për korrigjimin e Akteve të vdekjes	01
9.	Vendime për korrigjimin e Akteve të martesës	01
10.	Aplikime për natyralizim(fitim të shtetësisë)	84
11.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	08
12.	Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës	00
13.	Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë	00
	TOTALI	5587

Numri i dokumenteve të lëshuara:

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara
1.	Ekstrakt i lindjes	12026
2.	Certifikata të lindjes	5391
3.	Certifikata të martesës	2197
4.	Certifikata të vdekjes	835
5.	Certifikata të Statusit martesor	468
6.	Certifikata të shtetësisë	970
7.	Certifikata familjare	2199
8.	Certifikata të vendbanimit	2724
9.	Vërtetim nga arkivi	1608
Gjithsej		28418

Regjistrime të bëra në Regjistrat e Gjendjes civile

1.	Regjistrime të lindjes	106
2.	Martesa	234
3.	Regjistrime të vdekjes	149
4.	Regjistrime të Shtetësisë	138
5.	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	50
6.	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	30
7.	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	46
9.	Shkurorëzime	52
Gjithsejtë regjistrime të bëra		805

Ne këtë periudhë janë verifikuar 117 qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri më 19.02.2013 janë te verifikuar apo te regjistruar ne sistemin e gjendjes civile 101847 qytetar të komunës së Vushtrisë.

Qendra për Shërbim të Qytetarëve

Qendra për shërbim të qytetarëve në komunë gjatë kësaj periudhe ka qenë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Vushtrisë, duke iu dhënë informacionet e duhura në lidhje me kërkesat e tyre, duke iu ndihmuar në përpilimin e kërkesave dhe duke përcjell përgjigjet në kërkesa nga të gjitha drejtoritë.

Përveç aktiviteteve dhe detyrave të përditshme zyrtarët e qendrës së shërbimeve të qytetarëve kanë qenë të angazhuar edhe në punë të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorëve të tyre siç janë, menaxherë të kontratave, komisione për vlerësim, komisione për pranim dhe në komisione të tjera sipas nevojave zyrtare.

Objektiv i përgjithshëm strategjik i Qendrës për Shërbim të Qytetarëve ka qenë:

- Shërbime administrative kualitative, të qasshme, të bazuara në procedura administrative të arsyeshme dhe duke përdorur metodat e e-qeverisjes të orientuara kah nevojat e qytetarëve dhe bizneseve.
- Arkivimi elektronik dhe digjitalizimi i arkivit komunal,

Vazhdon përpjekja për implementimin e koncept dokumentit te punuar nga grupi punues për administratë i Komunës së Vushtrisë në bashkëpunim me grupin punes nga Komuna e Vaxjo-Suedise për një administratë digjitale dhe një arkiv digjital.

Tabela e mëposhtme përshkruan numrin e kërkesave të parashtruara në drejtoritë komunale të cilat janë pranuar nga zyrtaret e QSHQ-se.

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 29685 kërkesa, prej të cilave janë:

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave
1	Drejtoria për Administratë	19159
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	3813
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1079
4	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	146
5	Drejtoria për Shërbime Publike	364
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1509
7	Drejtoria për Arsim	494
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	456
9	Drejtoria për Inspektion	516
10	Personeli	673
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	358
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	304
13	Zyra Ligjore	6
14	Kryetari i Komunës	522
15	Drejtoria e Prokurimit	7

16	Kuvendi i Komunës	90
17	Zyra Lokale e Komuniteteve	3
18	Njësia e Auditimit të Brendshëm	0
19	Drejtoria Për Ekonomi dhe Investime Kapitale	186
20	Drejtoria për diasporë dhe Integritet Evropian	0
		29685

Arsimi

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri ka menaxhuar mbarëvajtjen e procesit mësimor gjithnjë sipas kalendarit të vitit shkollor 2024/25. Gjysmë vjetori i dytë ka filluar më 8 janar 2025 ndërsa ka përfunduar për klasën 12 –të (maturantë) me datë: 15.05.2024, për klasat 9, 10, 11, më datë: 5.06.2025, për klasat parafillore dhe 1-8 –të më: 23. 06. 2024.

Informata të përgjithshme:

- Numri i përgjithshëm i institucioneve edukativo-arsimore;;
- 2 çerdhe dhe 1 paralele e ndarë fizikë e cila është në procedurë të pavarësimit;
- 3 shkolla fillore;
- 2 Shkolla të mesme të ulëta;
- 27 Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta;
- 3 shkolla të mesme të larta;
- Numri i punonjësve: 1124;
- Numri i paraleleve: 642;

Numri i nxënësve:

- Niveli 0: (grup moshat 1-6 dhe çerdhet) 1046 fëmijë/nxënës;
- Niveli 1(klasa 1-5): 4721 nxënës;
- Niveli 2 (klasa 6-9): 3951 nxënës;
- Niveli 3 (klasa 10-12): 2193 nxënës;
- Gjithsej nxënës: 11911 nxënës;

Duke pasqyruar punën e DKA-së, drejtorëve, mësimdhënësve, nxënësve dhe personelit tjetër arsimor, për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024/25, ka pasur suksese dhe sfida në përmbushjen e objektivave të përcaktuara, të cilat janë paraqitur në këtë raport . Këto zhvillime u bënë duke u ndarë detyrat me kohë me qëllim të përgjegjësisë dhe llogaridhënies reciproke.

Gjatë kësaj kohe u realizuan këto aktivitete:

- Janë zhvilluar monitorime në të gjitha shkollat e Komunës së Vushtrrisë, e që në objektivat kryesor kishin: fushën e menaxhimit dhe qeverisjes së shkollës në funksion të sigurimit të cilësisë;
- Takime të rregullta me Inspektorët Regjional të Arsimit;
- Takime të rregullta me MASHTI;
- Takime të rregullta me KFORIN sloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumi për Arsimit;

- Gjatë kësaj periudhe janë pensionuar 11 mësimdhënës, 25 mësimdhënës në pushim të lehonisë, dhe janë shpallur 17 konkurse;
- Në të gjitha shkollat u shënua dita e internetit të sigurt;
- Është organizuar java e dyerve të hapura, ku nxënësit e klasave të IX-ta janë pritur nga shkollat profesionale;
- U mbajt program artistik për nderë të 7 marsit- Ditës së mësuesit;
- Transporti i nxënësve është realizuar në 35 vija udhëtuese;
- Certifikimi i 50 mësimdhënësve të SHMU-2 Vushtrri, i cili trajnim u krye me bazë në shkollë;
- 46 nxënës të Vushtrrisë u përfshin në projektin Drejt Malit, skijim në Brezovicë, 20 nxënës të SHMU-2, 20 nxënës të SHFMU "Liria" Stroc, dhe 6 nxënës që kanë fituar në garat e matematikës;
- U shënua dita e internetit në shumicën e shkollave të komunës së Vushtrrisë;
- Me datë 19.02.2024 Në Vushtrri, Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me shtëpinë botuese "Hamilton House" organizuan garën "Spelling Bee 2025", me pjesëmarrjen e 130 nxënësve nga shkollat e qytetit. Kjo garë u mbajti në Gjinnazin "Eqrem Çabej" Vushtrri. Ky aktivitet ka për qëllim të nxisë nxënësit që të përmirësojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze dhe të rrisin shkathtësitë e komunikimit;
- Bashkëpunimi me shkollat e shtetit të Maqedonisë, me programin e nxënësve të SHMP "Bahri Haxha" dhe nxënësve të Tetovës në projektin "Super shkollat";
- U mbajt ligjëratë nga policia në 10 shkolla me temë: "Siguria në trafikun rrugor" si dhe "Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik";
- Më 05.03.2025, fond i Eficiences se Energjisë, një eksperte e energjisë, përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, përfaqësues nga komuna si dhe nga Giz dhe INDEP organizuan; ekspozitë "Ndriçojmë të Ardhmen" – ekspozitë dhe shpërblime për tre pikturat më të mira. Vendi i parë SHMU-1, Vendi i dytë Gjinnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri, Vendi i tretë SHMU-2 Vushtrri. Të tri shkollave ju dhurua nga një Smard board me vlerë 1654 euro;
- U realizua hulumtimi nga Selim Mehmeti – IPK në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit jemi duke bërë një studim për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve;
- Më datë 11 mars 2025 u mbajtën garat e Olimpiadës së Gjuhës shqipe.
- Ju vlerësua përformanca e drejtorëve të shkollave: SHMU-2, SHMP "Bahri Haxha" . SHF "Naim Frashëri", SHFMU "Rilindja", dhe SHFM 28 Nëntori dhe zëvendës drejtori i "Lutfi Musiqi;
- Me datën: 25.04.2025, në Shtëpinë e Kulturës "Hasan Prishtina"-Vushtrri u mbajt festivali për fëmijë "Zëbylbylat e Vicianës" në të cilin morë pjesë 21 nxënës të shkollave të komunës së Vushtrrisë;
- Me datën 30 prill 2025 në Gjinnazin "Eqrem Çabej" u mbajt Panairi i Shkencës dhe Kulturës, i cili i filloi punimet nga ora 10:00 deri në ora 15:00. U mbajt testit PISA me datë: 13, 14 maj 2025 ku morën pjesë 319 nxënës;
- SHFMU "Enver Hadri" Srmekonicë: kompania Instabuild i ka dhënë donacion një SMARD Board dhe një fotokopje;
- Gjatë periudhës janar – qershor 2025 Ekipi Komunal për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore ka vlerësuar gjithsej 19 nxënës.
- Gjatë kësaj periudhe kemi shënuar Ditën Ndërkombëtare të Arsimit (24 janar), maturantët e gjinnazit "Eqrem Çabej" vizituan Bibliotekën Kombëtare të Kosovës të organizuar nga DKA në bashkëpunim me menaxhmentin e gjinnazit dhe po ashtu me aktivitetet të ndryshme në shkolla u shënua kjo ditë;
- Janë mbajtur takime të rregullta me ekipin e EPRMB-së me qëllim të zvogëlimit të braktisjes së arsimit parauniversitar;
- Siguria e të dhënave dhe mbrojtja e tyre në internet, aktiviteti i mbajtur në SHFMU "A.Z.Çajupi";
- Kemi shënuar Ditën Botërore të Down Syndrome 21 Marsi;
- Kemi realizuar projektin për matjen e nivelit të stresit dhe ndikimin e tij në performancën e punës të shërbyesit civil- Dita Ndërkombëtare e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (28 Prill);

- Kemi realizuar dy takime pune me drejtorin dhe mësueset udhëuese të Qendrës; Burimore “Nënë Tereza” në Mitrovicë për zgjerimin e bashkëpunimit në vazhdimësi;
- SHMP “Bahri Haxha” Vushtrri: - Janë pajisur me SMART TV të gjitha klasat e mësimi dhe kabinetet (planifikim me buxhetin e shkollës)
- Janë pajisur me laptop personal të gjithë mësime të mësimit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- Është realizuar projekti për përmirësimin e kushteve në firmën ushtrimore të Ekonomisë me 20 kompjuter të ri dhe një Smartbord financiar nga MASHTI;
- Ka vazhduar projekti mësimi në vendin e punës mbështetur nga GFA/GIZ dhe 170 nxënës të klasave XI dhe XII kanë kryer praktikën në vendin e punës;
- Ka vazhduar „Mësimi dual,, për 24 nxënësit e profilit „Tregtarë me pakicë dhe shumicë,, klasa e XI (ka pasur vështirësi për shkak të mosgatishmërisë së bizneseve për të përmbushur kontratat me nxënës ku parashihet edhe pagesa mujore);
- Janë pajisur me pajisje bashkëkohore për realizimin e praktikës profesionale kabinetet e kimsë, teknologjisë ushqimore dhe agrobiznesit (planifikim me buxhetin e shkollës);
- SHMP „Bahri Haxha” është pjesë e programeve të Erasmus+ me projektin CultiVeting ndër shkollat e para publike e përfshirë në këtë 22 nxënës janë trajnuar dhe certifikuar në trajnimin „Edukimi i të rinjve për artin, kulturën dhe trashëgiminë”;
- Është finalizuar projekti për realizimin e grantit të fituar nga RCF;
- Në SHMP „Bahri Haxha”, ka përfundur digjitalizimin e procesit mësimor.
- Janë organizuar Garat komunale për klasat e V-ta; vendi I, SHF “Mustafë Venhari”, vendi II SHFMU “A. Z. Çajupi” poashtu vendin II SHF “ Naim Frasheri”.
- Drejtoria për Arsime, me 16.07.2025 ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Childproof (CIPOF) për hapjen e dy kopshteve të reja me bazë në komunitet, në fshatrat Stanoc i Epërm dhe Shtitaricë;
- Me datë; 18.06.2025 u përruan kabinetet moderne të Kimisë, Fizikës dhe Biologjisë në ShMU-2;

I. Bursat dhe shpërblimet për nxënës

- Numri i bursave brenda vendit – 70 (shtatëdhjetë);
- Vlera e bursës – 600.00 € (gjashtëqind euro) për një student/e për studime brenda vendit;
- Numri i bursave jashtë vendit - 15 (pesëmbëdhjetë);
- Vlera e bursës – 800.00 € (tetëqind euro) për një student/e për studime jashtë vendit;
- Vlera e bursës- 1000.00 € (një mijë euro) për student/e për vendet e BE-së;
- Konkursi i bursave ka qenë i hapur nga data: 18.03.2025 - 01.04.2025
- Komisioni i ndarjes së bursave është përbërë nga: Enver Bajrami, kryesues i komisionit, Sadete Gërguri, anëtare e komisionit dhe Hashim Hajrizi, anëtar i komisionit;
- Komisioni i ankesave për studentët të cilët nuk kanë përfituar bursë është përbërë nga: Musaj Tërbunja, kryesues, Arianit Jashari, anëtar, dhe Bastri Duraku, anëtar;
- Gjithsej aplikantë të bursave 180, prej tyre 39 kanë aplikuar për drejtimet të cilat nuk i kemi shpallur. Fitues të bursave 85 studentë.
- Më datë: 15.04.2025, komisioni shpalli listën jo- përfundimtare të bursave;
- Më datën: 28.04.2025 komisioni i ankesave shqyrtoi 14 ankesa,
- Më datën: 30.04.2025 është shpallë lista përfundimtare e bursave;
- Në konkurrencë brenda vendit kanë tepëruar 15 bursa dhe janë bartur në këtë kategori duke u bazuar në notën mesatare;
- Ndërsa jashtë vendit
- kanë tepëruar 2 bursa dhe janë bartur në këtë kategori duke u bazuar në notën mesatare;
- 39 studentë kanë konkurruar nga drejtimet të cilat nuk i kemi shpallur;
- Përfitues të bursave sipas gjinisë: 57 janë studente, dhe 28 janë studentë;

- Studentë në Greqi – në York city colge janë 3 studentë 2 baç dhe 1 master dhe janë subvencionuar 17.185.00 euro
- Gjithsej përfitues 87 studentë më vlerë euro 72.185.00.

Shpërblimet e nxënësve:

- Janë subvencionuar për transport 79 nxënës me nevoja të veçanta arsimor me nga 500 euro në vlerë totale 39 500 euro;
- Janë subvencionuar 7 nxënës të cilët kanë përfaqësuar vendin në gara ndërkombëtare ku 6 prej tyre me nga 500 euro dhe 1 me 1000 euro pasi që ka marr pjesë në universitetin Santa Cruz në Kaliforni - USA. Gjithsej 4000.00 euro;

II. Garat, aktivitetet dhe të arriturat

- U mbajtën garat e diturisë në tri nivele për nivelin ka fituar vendi e parë: SHF “Mustafë Venhari” Vushtrri, vendi i dytë: SHFMU “A. Z. Çajupi” dhe SHF “Naim Frasheri” ndërsa në nivelin 2 vendin e parë SHMU-2, Vendin e dytë SHFMU “Enver Hadri” Smrekonicë, Vendin e tretë SHFMU “Hajrullah Shala” Akrashticë
- Garat regionale në Kimi; Anisë Kutllovci- X/3- Vendi i Parë, Melika Tiriqi – X/4- Vendi i Dytë, Tina Gashi- XI/1- Vendi i Dytë, Armelinda Shala- XI/5- Vendi i dytë, Redon Hajrizi – XI/6- Vendi i tretë;
- Garat Komunale në Fizikë; Klasët e 10-ta, Ajdesë Kadriu – Vendi i parë Tuana Sadiku – Vendi i dytë, Ilajda Hoxha - Vendi i tretë. Klasët e 11-ta, Aida Kovaçi- Vendi i parë, Tina Gashi – Vendi i dytë, Redon Hajrizi – Vendi i tretë Klasët e 12-ta, Erti Rushiti- Vendi i parë, Bedri Haliti- Vendi i dytë; Garat Republikane në Fizikë; Erti Rushiti- Vendi i tretë,
- Garat Komunale në Futsall; Vendin e parë djemtë dhe vajzat;
- Garat Komunale në Basketboll; Vendin e parë djemtë dhe vajzat;
- Garat Komunale në Volejbol; Vendin e parë.
- SHFMU “Liria” Stroc: ka zënë vendin e parë në nivel republike në garën Spelling Bee. Nxënësi Rrezon Aliu ka fituar vendin e parë ku shkolla ka fituar një set me libra dhe nxënësi ka fituar një lpad.
- SHFMU- Nedakoc në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2024/2025 është Vendi i parë në garën komunale për esenë më të mirë.
- Nxënësit tanë kanë zënë 6 vende të para, në këto disiplina:
- Matematikë (klasa 7, 8 dhe 9)
- Fizikë klasa 9
- Gjuhë shqipe klasa 9
- Gara e diturisë (në 5 lëndë: gjuhë shqipe, histori, kimi, biologji dhe TIK)
- Gjuhë angleze 4 nxënës kalojnë në nivelin republikan.
- Niveli Republikan:
- Kimi: 7 finalistë, prej të cilëve një nxënës zuri vendin e parë në garë.
- Niveli Ndërkombëtar:
- Art Figurativ: 1 nxënës i shpërblyer
- Gjuha angleze: 3 nxënës të suksesshëm.
- Për të përmbledhur sukseset:
- 13 vende të para – 13 kupa të fituara gjithsej:
- • 6 në nivel komunal - vende të para- dy hendboll për djem dhe vajza një shah një dy pingpong djem/vajza
- • 4 në nivel rajonal - vende të para 2 hendboll për djem dhe vajza një shah dhe një pingpong
- • 3 në nivel republikan - vende të para (2 hendboll për djem dhe vajza) dhe shah

III. Vlerësimet e jashtme

Testi i maturës 2025

Testi i maturës u mbajt me 21 qershor 2025, në 5 qendra testimi. Në test morën pjesë tre institucione të arsimit të mesëm të lartë: Gjimnazi "Eqrem Çabej", SH.M.T. "Lutfi Musiqi", dhe SH.M.P. "Bahri Haxha" Vushtrri. Gjatë këtij viti pati në ndryshime në proces të testit maturës si në paraqitje e provimit shtetëror dhe ndarja e nxënësve gjatë testimit.

Përmes tabelës dhe grafikeve pasqyrojmë përqindjen e kalueshmërisë dhe krahasimit me vitin paraprak.

SHKOLLA:	2024	2025	Krahasueshmëria
Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri	88.80%	90.00%	-1.20%
SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri	49.80%	42.00%	7.80%
SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri	58.82%	41.84%	16.98

Testi i Arritshmërisë 2025

Testi i Arritshmërisë u mbajt më 27 qershor. Në test u përfshin 9 lëndë dhe gjithsej 100 kërkesa (pyetje, detyra). Drejtoria Komunale për Arsim ka digjitalizuar dhe përpunuar të dhënat e testit të arritshmërisë dhe ka nxjerrë analiza statistikore të cilat do të jenë shumë të dobishme për Drejtorinë dhe shkollat e komunës sonë.

Nr. i kërkesave:

1. Gjuhë shqipe	20 pyetje
2. Gjuhë angleze	5 pyetje
3. Histori	13 pyetje
4. Gjeografi	12 pyetje
5. Matematikë	20 pyetje
6. Informatikë	5 pyetje
7. Fizikë	8 pyetje
8. Kimi	8 pyetje
9. Biologji	9 pyetje

Lënda:	Kalueshmëria në %, viti 2024	Kalueshmëria në %, viti 2025	Krahasimi
Mesatarja në nivel Komune	47.79	44.87	2.92

Kalueshmëria në shkolla:

Nr.	Shkolla	Përqindja	Meshkuj	Femra
1	SHMU-2 Vushtrri	49.18	48.26	50.29
2	SHFMU "Mustafë Shyti" Oshlan	46.82	43.63	50.00
3	SHFMU "Rexhep Musa" Ceceli	95.21	90.41	99.42

4	SHFMU "12 Qershori" Mihaliq	44.39	46.87	39.21
5	SHFMU - Nedakoc	42.21	25.07	17.14
6	SHMU-1	52.26	52.27	52.25
7	SHFMU "Rilindja" Maxhunaj	41.82	42.29	41.36
8	SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri	50.76	49.78	51.87
9	SHFMU "Adem Voca" Pasomë	49.20	44.85	59.33
10	SHFMU Pestovë	97.31	88.42	113.31
11	SHFMU "Nazmi Zhegrova" Stanoc I P.	47.14	27.91	19.22
12	SHFMU "Latif Berisha" Doberllukë	46.84	42.60	52.15
13	SHFMU "Bahri Kuqi" Shtitaricë	45.78	45.01	46.91
14	SHFMU "Enver Hadri" Smrekonicë	52.96	58.53	47.80
15	SHFMU "Liria" Stroc	0.46	0.42	0.49
16	SHFMU "7 marsi" Bukosh	45.60	40.33	49.95
17	SHFMU "Dëshmorët" Zhilivodë	36.30	33.20	40.98
18	SHFMU "28 Nëntori" Vërrnicë	51.24	55.52	47.49
19	SHFMU "Lumni Surdulli" Samadrexhë	43.28	39.67	45.29
20	SHFMU "Migjeni" Stanoc i E.	42.02	42.30	41.58
21	SHFMU "Jusuf Gërvalla" Dumnicë e P.	0.41	0.40	0.42
22	SHFMU "Bajram Curri" Dumnicë e Ll	0.49	0.59	0.43
23	SHFMU "Emin Duraku" Novolan	47.47	44.90	53.14
24	SHFMU "Gj.K.Skenderbeu" Pantinë	54.10	56.70	50.70
25	SHFMU "Hajrullah Shala" Akrashticë	50.11	48.00	52.75
26	SHFMU "Martirët" Reznik	49.58	41.42	55.30
27	SHFMU "Azem Bejta" Doboc	46.90	50.68	42.58
28	SHFMU "Abdyl Frashëri" Druar	43.60	42.78	47.51
29	SHFMU "Lummadh"	35.75	29.95	53.14
	Kalueshmëria	44.87	41.94	45.51

IV. Investimet nga komuna

- Adaptimi i qendrës së kulturës në Shtitaricë dhe për çerdhe me vlerë 135,942.70 €;
- Adaptimi i shkollës së vjetër në Stanoc të epërm për çerdhe me vlerë 204,132.15 €;
- Rregullimi i hyrjes së shkollës me e qeramikën në n Studime të Epërme 4,366.00 €;
- Renovimi i dyshemesë së klasave në SHMU-2 me vlerës 82,476.00€;
- Rregullimi i platos në SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri me vlerë 69,515.00€;
- Renovimi i dyshemesë së klasave në SHMU-1 me vlerës 2,557.50 €;
- Ngjyrosja me fasadë hapësirat e brendshme të shkollës në SHFMU "Gj.K.Skënderbeu" Pantinë me vlerë 5,124.00€;
- Ndërtimi i shkollës "Musafë Venhari" vazhdim i projektit 2024;
- Në SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri janë vendosur dyer e reja dhe panelet e ndriçimit me vlerë 9000.00€ dhe tualet 8000.00€;

V. Donacionet

- Gjumnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri: ka pranuar donacion Smartbord me vlerë 1164 euro, donacion nga GIZ në bashkëpunim me Indep. Donacion me vlerë 400 euro nga Shtëpia Botuese PEMA, për bibliotekën e shkollës. Donacion nga Qendra për Arsimin e Kosovës (KEC) në partneritet me Ipko

Foundation (IF), Laptop Lenovo, Sasia 1. NP "Përparimi", 500 lule dhe 8 pisha për ambientin e shkollës;

- SHFMU "Emin Duraku" Novolan: Donacion nga KFORI danez në vlerë prej 2000 euro, dhe pajisja e të gjitha klasave me klima të gjitha donacion nga Danimarka. Donacion rregullimi i perdeve nga prindi Emin Muzaqi për klasën e IX-të. Donacion nga mërgimtari Arian Dërguti në vlerë 280 euro, materiale shkollore për nxënës si dhe renovimi i pllakës së emrit të shkollës. Donacion anonim me një kontingjent prej 200 librave për pasurimin e bibliotekës së shkollës sonë;
- SHMU-2 Vushtrri ka përfituar donacion 2 aparata të ujit Sharjah Charity International;
- SHMU-1 Vushtrri ka përfituar donacion 1 aparata të ujit Sharjah Charity International;

VI. Suksesi i gjysmëvjetorit të dytë 2024/25

Suksesi i gjysmëvjetorit të dytë, viti shkollor 2024/25 klasa 1- 5, krahasuar me periudhën e njëjtë							
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të pa notuar	Përcillen me nota negative
2024	65.89%	19.40%	11.19%	3.30%	0.17%	0.00%	0.0004
2025	66.87%	19.25%	10.74%	3.03%	0.07%	0.02%	0.02%
Krahasueshmëria	-0.98%	0.15%	0.45%	0.27%	0.10%	-0.02%	0.02%

Suksesi i gjysmëvjetorit të dytë, viti shkollor 2024/25 klasa 6- 9, krahasuar me periudhën e njëjtë							
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të pa notuar	Kanë përsëritur klasën
2024	28.46%	21.69%	27.96%	15.78%	5.75%	0.05	0.28
2025	29.54%	21.92%	26.72%	13.72%	7.08%	0.14	0.88
Krahasueshmëria	-1.08%	-0.23%	1.24%	2.06%	-1.33%	-9.00%	-0.60%

Suksesi i gjysmëvjetorit të dytë, viti shkollor 2024/25 klasa 10- 12, krahasuar me periudhën e njëjtë							
Periudha e njëjtë	Shkëlqyeshëm	Sh. Mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Të pamjaftueshëm	Të pa notuar	Kanë përsëritur klasën
2024	14.61%	19.90%	32.32%	21.05%	8.35%	2.69%	1.05%
2025	13.94%	20.08%	31.25%	23.44%	9.13%	1.27%	0.63%
Krahasueshmëria	0.67%	-0.18%	1.07%	-2.39%	-0.78%	1.42%	0.42%

Nota mesatare për lëndë klasa 1-9

Klasa	Art figurativ	Biologji	Edukatë fizike, sportit dhe	Edukatë muzikore	Edukatë qytetare	Fizikë	Gjeografi	Gjuhë angleze	Gjuhë frënge	Gjuhë gjermane	Gjuhë shqipe	Histori	Kimi	Lëndë që zgjedhen nga	Matematikë	Njeriu dhe natyra	Shkathësi për jetë	Shoqëria dhe mjedisi	Teknologji me TIK
Klasa 1	4.8 6	0	4. 89	4. 86	0	0	0	4. 7	0		4. 58	0	0	4. 84	4. 59	4. 72	4. 8	4. 76	
Klasa 2	4.8 1	0	4. 89	4. 8	0	0	0	4. 5	0	0	4. 42	0	0	4. 66	4. 39	4. 51	4. 66	4. 56	
Klasa 3	4.6 3	0	4. 82	4. 62	0	0	0	4. 19	0	0	4. 09	0	0	4. 39	4. 02	4. 08	4. 44	4. 22	
Klasa 4	4.5 6	0	4. 81	4. 57	0	0	0	4. 1	0	0	4. 09	0	0	4. 29	3. 98	4. 03	4. 29	4. 12	
Klasa 5	4.6 2	0	4. 86	4. 62	0	0	0	4. 11	0	0	4. 05	0	0	4. 38	3. 91	4. 01	4. 39	4. 11	
Klasa 6	4.1	3. 48	4. 51	4. 11	3. 65	3. 51	3. 54	3. 7	3. 97	3. 68	3. 63	3. 55	3. 88	4. 09	3.				3. 7
Klasa 7	4.0 5	3. 28	4. 54	3. 79	3. 42	3. 05	3. 29	3. 44	3. 68	3. 4	3. 25	3. 41	3. 15	3. 49	3. 06				3. 5
Klasa 8	3.9 9	3. 29	4. 3	3. 94	3. 46	3. 22	3. 28	3. 7	3. 8	3. 34	3. 37	3. 42	3. 22	3. 6	3. 1				3. 7
Klasa 9	4.0 9	3. 34	4. 6	4. 05	3. 64	3. 33	3. 55	3. 63	3. 49	3. 43	3. 47	3. 52	3. 25	3. 65	3. 08				3. 7
Mesa tarja	4.4 1	3. 35	4. 69	4. 37	3. 54	3. 2	3. 37	4. 01	3. 74	3. 46	3. 88	3. 48	3. 38	4. 15	3. 71	4. 27	4. 52	4. 35	3. 6

Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Drejtorja për shëndetësi dhe përkujdesje sociale dhe menaxhmenti i QKMF-së bazuar në Strategjinë Sektoriale të KPSH dhe në zbatueshmëri me planin e punës kanë qenë dhe janë të përkushtuar maksimalisht që të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore, ku përfshihen ato promovuese, parandaluese, diagnostikuese, trajtuese dhe paliative, duke përfshirë në procesin e përkujdesjes shëndetësore për të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Vushtrrisë.

Përkujdesja shëndetësore organizohet duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e popullatës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

QKMF-ja është përgjegjëse për organizimin, implementimin e konceptit të Mjekësisë Familjare si dhe sigurimin e vazhdimësisë të përkujdesjes shëndetësore për popullatën me objektivë kryesorë, përmirësimin

e shëndetit të popullatës, duke ju ofruar shërbime të qasshme, gjithëpërfshirëse si dhe shërbime të cilësisë së lartë.

BASHKËPUNIMI ME DONATOR

Gjatë periudhës kohore TM1-TM2 të vitit 2025 DSHPS dhe QKMF kemi arritur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me donator për realizimin e projekteve me bashkëfinancim.

- Bashkëpunimi me donatorin AQH e Zvicrës, është duke vazhduar në kuadër të zhvillimit të edukimit të vazhdueshëm profesional.
- Bashkëfinancimi për renovimin e hyrjes së Laboratorit në QMF-, vlera 20,000.00 Euro.
- Donacion nga Ipko furnizimi me pajisje mjekësore vlera mbi 17,000.00 Euro.
- Kryetari i Komunës Vushtrri dhe Islamic Relief me seli në Prishtinë kemi vazhduar projektin i cili ka pasur nismën dhe funksionalizimin në vitin 2017 në bazë të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve në fushën e shëndetësisë për projektin e vizitave shëndetësore në shtëpi, ku kemi përmirësuar, për perkujdesjen ndaj qytetarëve të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në krahësim me vitet e kaluara, me numrin e stafit profesional mjekësor të angazhuar 7 ditë të javës /13 orë, me dy ekipe mjekësore të përbëra nga 1 mjek dhe dy infermier, me dy automjete.
- Në bashkëpunim me UNICEF kemi vazhduar projektin për vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare.

Raporti i shërbimeve shëndetësore janar – qershor 2025

Në vijim do gjeni informacionin lidhur me pacientët të cilët kanë marrë shërbime shëndetësore në QKMF, QMF dhe AMF të Komunës së Vushtrrisë, në periudhën kohore prej 01.01.2025 deri më 30.06.2025.

- Gjithsejtë pacientë: **113,906**
 - Meshkuj: **52,670**
 - Femra: **61,236**

Janë ofruar këto shërbime :vizita konsultime nga mjekët familjar shërbimi i stomatologjisë, Shërbime Urgjencës 24 orë, dhoma e infuzioneve dhoma e tretmanit, dhoma e vaksinim, këshillimorja për planifikim e familjes, këndi i rehidrimit, dhoma e inhalimit, dhoma e lidhtorës, laborator, rëntgeni, RTG e dhëmbit si dhe vizitat shtëpiake për shtatzëne dhe për të sapolindurit dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeçare etj.

❖ Participimet

- Numri i përgjithshëm i pacientëve që kanë participuar është: **23935**
- Pacientët që kanë participuar nëpërmjet marrjes së certifikatave është **135**
- Shërbimet në QKMF/QMF dhe AMF janë **:470,209**
- Referimet **8,862**
- Personat me aftësi të kufizuara: **609**
- Numri i përgjithshëm i vizitave shtëpiake për shtatzëne: **180**
- Fëmijët deri në moshën 3 vjeçare: **5**

• Sëmundjet kronike :

- Numri i sëmundjeve Malinje : 378 (të raportuar nga mjekët në raporte mujore)
- Numri i sëmundjeve kronike:9535 (të raportuar nga mjekët në raporte mujore)
- Numri i Pacienteve Paliativ: 951 (Raportuar nga shërbimi i Urgjencës)
- Numri i pacienteve nga Mjeku Priva me terapia parenterale 10,411

Në vijim janë paraqitur në formë tabelare rrjetet e QMF dhe AMF Janar-Qershor 2025 në kuadër të QKMF për vizitat mjekësore 2025

6 mujori 2025												
Nr.	Emri i shërbimit	Totali	Meshkuj	Femra	Participim	Shërbime	Referime	Malinje	Kronike	Nga Mjeku Privat		Paliativ
										Inek.	Infuzi	
1	QKMF	31397	14720	16677	6553	92875	1579	52	1909	1365	2496	32
2	Urgjenca	16130	7432	8698	3146	79654	2284	132	3343	1175	1581	900
3	Laboratori	7043	3045	3998	1623	58793	0	0	0	0	0	0
4	Stomatologjia	4002	1889	2113	530	16047	83	0	0	190	0	0
5	RTG	2755	1291	1464	829	7667	0	0	0	0	0	0
6	Rtg e dhëmbit	224	86	138	61	488	0	0	0	0	0	0
7	Vaksinimi	2523	1358	1165	0	6684	0	0	0	0	0	0
8	QMF-1	31543	14494	17049	7968	111716	2407	133	1853	1487	800	19
9	QMF-2	2925	1304	1621	424	21361	288	0	291	298	193	0
10	QMF-3	3704	1775	1929	804	24624	22	0	678	144	88	0
11	QMF-AMF	11660	5276	6384	1997	50300	2199	61	1461	325	269	0
	Gjithsejtë	113 906	52 670	61 236	23 935	470 209	8 862	378	9 535	4 984	5 427	951

Në formë tabelare rrjetet e QMF dhe AMF Janar-Qershor 2025

	2025 6 mujori	Totali	M	F	Referimet	Participim	Shërbi me tjera	Vizita me kartel e	S.Malinje	S.Kronike	Nga Mjeku Privat	
											I.M	Infuzione
QMF dhe AMF	QMF- Lumadh	3411	1435	1976	152	686	18353	253	29	217	226	184
	QMF- Smrekonicë	1618	803	815	316	313	5028	70	6	212	16	14
	QMF- Pantinë	1120	452	668	480	223	4978	0	8	214	11	18
	QMF -Druar	855	397	458	359	120	2584	58	3	30	12	5
	QMF- Novolanë	371	197	174	16	1	1157	2	0	20	13	17
	QMF- Maxhunaj	2245	1065	1180	457	568	6567	0	0	280	22	16
	QM-F Dumnicë	246	91	155	80	20	1416	0	0	8	5	3
	AMF- Samadrexhë	628	276	352	128	12	4539	183	0	160	20	5
	AM-F Strovç	341	147	194	94	33	1092	22	2	33	0	7
	AMF- Pasomë	279	136	143	6	4	1205	54	0	6	0	0
	AMF- Oshlan	228	111	117	0	3	189	23	0	0	0	0
	AMF- Beçiq	131	81	50	71	3	410	0	0	6	0	0
	AmF- Dubovc	36	22	14	5	0	97	0	0	2	0	0
	AMF -Ceceli	172	73	99	35	3	1213	0	0	20	0	0
	Gjithsej:	11681	5286	6395	2199	1989	48828	665	48	1208	325	269

Sektori i Shëndetit Publik

Është përgjegjës për imunizim dhe vaksinim dhe për Sistemin Informativ Shëndetësor, ky sektor përcjell gjendjen epidemiologjike në bazë të raporteve kthyes nga IRSHP dhe bashkë me ta vepron në rast se kërkohet apo dyshohet në ndonjë epidemi.

Qëllimi: Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Vushtrri, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të KPSH me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

Sëmundjet ngjitëse sipas Buletinit 6 mujor të IKSHPK Mitrovicë

Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse sipas komunës së Vushtrrisë, tab.2

Sëmundjet ngjitëse	Totali	Sëmundjet ngjitëse	Totali
Pneumoni/ARI	277	Meningjit serosa/sindroma meningjiale	0
ILI	1030	Parotitis epidemica	1
Diarea akute	322	Hepatit ac B	0
Variçella	103	Helmimet me ushqim	0
Influenca A	0	Fruth	0
Influenca B	0	Bruceloza	1
Tularemi	2	Salmonelloza	1
IST	1	TB	8
Sëmundjet tjera ngjitëse	220		

Influenca sezonale /ILI: Gjatë periudhës Janar - Qershor 2025 në QRSHP Mitrovicë janë raportuar 6562 raste me ILI. Numri i rasteve të raportuara është më i ultë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Diarea akute: Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, janë raportuar 3750 raste me Diare akute numër ky i konsideruar i rasteve por pa ndonjë veçori specifike i cili flet për karakter të epidemisë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, numri është më i ulët për por krahasuar me periudhë e vitit 2024, (3834 raste).

Pneumonia/ARI: Gjatë periudhës Janar – Qershor 2024, në QRSHP janë raportuar 805 raste me ARI ku numri i rasteve është më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak 2024 (529 raste). **Variçella:** Gjatë periudhës Janar- Qershor 2025 në QRSHP janë raportuar 278 raste me Variçellë dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (427 raste) vërehet një ulje e rasteve.

COVID-19: Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, në QRSHP Mitrovicë janë raportuar 0 raste me

Meningitis serosa : Gjate periudhës Janar - Qershor 2025 ne QRSHP janë raportuar 0 nga Komuna Vushtrri.

Sallmonellozis Vushtrri 1 rast.

Intoxicatio alimentaris 1 rast në Vushtrri.

HVAB 0 raste në Vushtrri.

Dyshimi në Pertusis 0 raste Vushtrri

Dyshimi në Morbil 0 raste në Vushtrri

Brucelozis 1 rast në Vushtrri dhe Tularemi 2 raste në Vushtrri

TBC-raste të reja 8 raste Vushtrri.

STT 2 1 rast në Vushtrri.

Shërbimi i Imunizimit pranë QKMF-Vushtrri ka qenë mjaftë i angazhuar për kryerjen e punëve dhe aktiviteteve që i përgjigjen këtij shërbimi. Gjatë periudhës Janar-Qershor ka kryer vaksinimin e fëmijëve të kalendarit të rregullt të imunizimit duke filluar nga te porsalindurit e deri tek fëmijët(nxënësit)e moshave përkatëse. Shërbimet janë kryer në QKMF dhe në gjashtë QMF të tjera.

Nr.	Vendi	Pacient	M	F	Shërbime
1	QKMF	1195	639	556	2700
2	QMF-1	776	438	338	1748
3	QMF-2	206	95	111	560
4	Lumadh	143	77	56	580
5	Maxhunaj	26	11	15	147
6	Smrekonicë	56	28	30	185
7	Pantine	96	59	38	248
	Gjithsej	2523	1358	1165	6256

Viti i dytë i administrimit të vaksinës HPV te vajzat (nxënëset) e moshës 12 vjeçe, ndërsa për djem ka qenë viti i parë i aplikimit të vaksinës HPV .

Te planifikuar kanë qenë 945 nxënëse, të vaksinuara te dy gjinitë janë 821 nxënës. Raportet janë edhe në tabelën e më poshtme.

Vaksinimi i nxënësve	Të Vaksinuar	Totali
KI- I-	896	896
Maturantat KL.XII	650	650
HP.V, vetum femra KI VI	821	821

Shërbimi i vaksinimit ka ofruar gjithsej 6256 shërbime . Ne mesin e fëmijëve te vaksinuar janë edhe një fëmijë Ashkali .

Është bërë menaxhimi i zinxhirit te ftohët në mënyrë të rregullt, furnizim me vakcina ka qenë i rregullt. Është në përfundim e sipër edhe rezultati nga vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para , të pesta dhe të nënta.

Me rekomandim te Ministrisë së Shëndetësisë ka fillua rivaksinimi i fëmijëve të cilët regjistrohen në klasën e parë, për vitin 2025/2026.

Gjithsej janë vaksinuar 307 nxënës të kësaj gjenerate.

Gjatë periudhës Shtator 2024 – Qershor 2025 janë administrua 2347 doza të vaksinës së gripit sezonal.

Njësia e SISH-it, është në vazhdimësi në përpjekje për arritjen e objektivit të përgjithshëm të funksionalizimit të BHIS Ministria e Shëndetësisë ka bërë shtrirjen e rrjetit për të gjitha QMF dhe AMF, po ashtu ka pajisur KPSH me pajisje kompjuterike dhe pajisje tjera të TI, është duke u punuar në vazhdimësi për implementimin e të gjitha qendrave dhe shpresojmë që gjatë vitit 2025 të funksionalizohet SISH-I në të gjitha institucionet e KPSH-së, meqë është shqetësuese mungesa e rrjetit të internetit dhe mungesa e printerëve.

Sektori i Shëndetit Oral Preventiv

Në sektorin e shëndetit oral preventiv janë vizituar gjithsejtë 4002 pacient dhe ka dhënë 17915 shërbime. KPSH në Vushtrri ka gjithësejt 9 stomatolog, sipas U/A 5000 banor për një stomatolog, andaj nevoja është për rritjen e numrit të stomatologëve.

Raporti 6 mujor i shërbimit të Stomatologjisë 2025

Muaji	Totali	M	F	Prej tyre te para	Vizita serike	Pa mjekim	Me mjekim	Dhëmbë të nxjerrë	Intervenime tjera	Shërbimet
Janar	843	414	429	848	2	2	341	189	201	4244
Shkurt	706	323	383	706	6	0	231	120	229	3161
Mars	476	226	250	485	0	2	137	110	167	2139
Prill	775	372	403	772	5	4	256	175	218	3281
Maj	697	328	369	698	0	1	186	151	155	2976
Qershor	505	226	279	505	2	1	198	108	138	2114
Gjithsej	4002	1889	2113	4014	15	10	1349	853	1108	17915

Shërbimi i Urgjencës

Raportimi Janar – Qershor 2025. Në Sektorin e Kujdesit Urgjent shërbimet shëndetësore ofrohen 24^h dhe punohet cdo ditë të javës. Janë të angazhuar katër ekiye që punojnë me ndërrime 12 orësh, janë të angazhuar 8 mjek dhe 17 infermier, këtu kryhen vizita mjekësore dhe shumë shërbime tjera që dalin nga këto vizita. Urgjenca transporton pacientet nga vendi i ngjarjes deri në Emergjencën e Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri e nëse kërkohet ndihmë nga Emergjencia e spitalit, transportohen sipas nevojës edhe në SHSKUK Prishtinë. Në disa raste ofrojnë vizita dhe shërbime shëndetësore edhe në shtëpi, kur gjendja e pacientit është e rënd.

Raporti janar – qershor 2025

Muaji	Rafet rim Tercial	Aksidentet	IM	IV	I.S.C	Infuzione	Glikemia	RK P	EKG	O2	Kateterizim	Lidhje	Rastet e terentit	S.M alin je	S.Kr onike	Mjek u priva t	Rastet emergj ente	Shërbi met	Dhun a ne famil je
Janara	430	19	850	228	70	382	314	10	399	68	6	100	93	19	627	408	490	16369	0
Shkurt	393	21	775	187	57	352	254	0	390	51	10	120	147	8	543	396	426	13115	0
Mars	375	28	697	181	46	444	234	4	308	36	5	76	95	19	635	401	410	12000	0
Prill	378	29	706	164	64	311	277	0	353	45	9	126	147	17	492	432	444	11255	0
Maj	378	29	706	164	64	311	277	0	353	45	9	126	147	17	492	432	569	14280	0
Qershor	414	22	700	139	54	290	205	1	263	44	15	106	288	31	496	393	499	12635	0
Gjithsej	2368	148	4434	1063	355	2090	1561	15	2066	289	54	654	917	111	3285	2462	2838	79654	

Spektori i Diagnostikës

Laboratori se bashku me Rëntgenin bëjnë pjesë në sektorin e diagnostikës.

Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2025 në Laborator ka pas gjithsejtë 7043 pacient dhe janë dhënë 73193 shërbime te ndryshme.

Në laborator janë 11 teknik laborant të punësuar dhe 2 tjerë janë nga IRW. Punohet prej orës 07 : 00^h – 14 : 00^h, dhe punohet 6 ditë javës.

Në vijim do gjeni informacionin lidhur me pacientët të cilët kanë kërkuar shërbime dhe kanë marrë shërbime shëndetësore në Laboratorin e QKMF-së

Nr.	Periudha kohore	Totali	Meshkuj	Femra	Pacient që kanë Particip	Shërbim	Përqindja/participim
1	Janar	1373	552	821	357	16071	26.00%
2	Shkurt	1349	544	805	328	14608	24.31%
3	Mars	850	412	438	189	8202	22.23%
4	Prill	1387	659	728	307	14971	22.13%
5	Maj	1023	445	578	212	8960	20.72%
6	Qershor	1061	433	628	230	10381	21.67%
Totali		7043	3045	3998	1623	73193	22.84%

Kemi kontratën aktive për furnizim me reagensë dhe material shpenzues laboratorik.

Jemi në procedurë të inicimit të aktivitetit të prokurimit për themelimin e kontratës për servisim dhe mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore sipas planit të prokurimit publik komuna Vushtrri.

Shërbimi i RTG .

Gjatë gjashtë mujorit të parë në shërbimin e Rëntgenit, në përgjithësi, shërbimet në kabinetin e rëntgenit janë kryer me kohë dhe pa terminë, puna është organizua në dy ndërrime 7:00h-13:00h dhe 13-19h ku janë të angazhuar katër punëtorë, gjatë muajit Maj dhe Qershor për shkak të pushimeve vjetore ndërrimi i pasdites nuk ka punuar, pacientët kanë marrë shërbime me filma dhe CD ,furnizimi me material hargjues ka qenë shume i mirë.

Në 6 mujorin e dytë është bërë zhvendosja e kabinetit të Rëntgenit në hapësira me të përshtatshme për punë edhe me rregulloren sipas standardeve.

Në shërbimin e RTG është vendosur edhe Mamografija e Gjirit, dhe pritjet të trajnohen tekniket e Radiologjisë për t'ju afruar shërbime qytetareve të Vushtrrisë

Edhe në RTG e dhëmbit janë krye afro 500 shërbime.

Rëntgeni i dhëmbit është në QKMF dhe nuk e ka dhomën e përshtatshme për fotografime .

BARNATORJA QËNDRORE

Për shkak të mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shëndetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës së Vushtrrisë të ndarë për blerjet e produkteve medicinale dhe material shpenzues, përmes kontratës për furnizime “MEDPLUS ShPK”:

Nr.	Vlera e blerjesë €
1	7,168.36
2	11,204.04
Totali	18,372.40

Në tabelën e mëposhtme keni të bashkangjitur përqindjen e furnizimeve nga M.Sh. me barna dhe material shpenzues për periudhën kohore janar – qershor 2025, nga lista esenciale:

Nr.	Muaji	Barnat	Material shpenzues
1	TM-1	45.79 %	64%
2	TM-2	39.25%	44%
	Mesatarja	42.52%	54 %

Depoja Qendrore Farmaceutike gjatë vitit 2025 ka bërë shpërndarjen e barnave dhe materialit shpenzues në gjithsej 18 QMF dhe AMF të komunës së Vushtrrisë, ne interval te caktuara kohore, QMF dhe AMF për çdo muaj, ndërsa QKMF dhe QMF-1 në intervale 2 javore.

ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional për mjekët dhe infermier, është komponent me rëndësi të veçantë për institucionin e QKMF-së. Në QKMF mbahen takime të rregullta me mjek dhe infermier të cilat organizohen përmes përgjegjëses për ZHVP. Gjatë vitit mbahen takime profesionale për profesionistët mjekësor për çdo muaj, 10 ligjërata , këto ligjërata nuk mbahen vetëm në muajin korrik dhe gusht. Zakonisht janë mbajtur ligjërata me tema që kanë qenë të përzgjedhura nga këshilli profesional i QKMF-së dhe nga ky vit janë të certifikuar nga OMK.

ZHVP për infermier gjithashtu mbanë ligjërata të përmuajshme për infermier dhe ligjërata në komunitet me theks të veçantë në edukim dhe promovim shëndetësor. Ligjëratat në komunitet mbahen zakonisht në viset rurale në objektet e qendrave shëndetësore apo në shkollat fillore, ligjërata mbahen edhe për adoleshentët në shkollat e mesme . Gjithashtu ZHVP se bashku me koordinatorin e cilësisë dhe qendrën trajnuese për infermier (QEV) i shënon ditët e caktuara botërore për sëmundje të ndryshme, me aktivitete jashtë institucionit dhe në bashkëpunim me punëtorë tjerë shëndetësor në QKMF.

Zh.V.P në QKMF Vushtrri është zhvilluar në bashkëpunim me QZHMF në Prishtinë dhe QTMF në Mitrovicë. E tërë kjo është menaxhuar nga kryetari i komitetit për Zh.V.P si bartës kryesor dhe një anëtar të komitetit si përgjegjës për Zh.V.P të stafit infermierik.

Aktivitetet e Zh.V.P janë organizuar në formë të ligjëratave.

Ligjërues kryesisht kanë qenë mjekët familjarë si dhe mjekët e specializimeve tjera. Ligjëratat janë bazuar në nevojat e participantëve dhe në bashkëpunim me të gjithë mjekët.

Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm

Në muajin shkurt filluam me trajnimet e gjata 5 ditore me teme “Infermiera në Kujdesin Parësor”

Trajnimi ka një modul i cili i ka gjithsej 10 tema. Trajnimi është mbajtur gjatë orarit të punës nga ora: 12:00 - 14:00.

Vizitat shtëpiake për gra shtatzëna, lehona dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeçe

Gjatë periudhës së parë të vitit 2025 janë realizuar gjithsej **744** vizita në shtëpi.

Për fëmijët janë realizuar gjithsej 565 vizita në shtëpi. Prej tyre në 116 vizita është aplikuar instrumenti ndërkombëtar për monitorimin e zhvillimit të fëmijëve “GMCD”

Për shtatzënat janë realizuar 179 vizita në shtëpi, prej të cilave numri i shtatzënave që janë vizituar për herën e parë është 62, kurse numri i shtatzënave të vizituar për herën e dytë është 117 (këtu përfshihen edhe vizitat shtesë, të tilla si këshilla për ushqyeshmërinë e shëndetshme gjatë shtatzënisë, këshilla për gjidhëniën, këshilla për imunizimin e fëmijëve, këshilla për rritje dhe zhvillimin e fëmijëve, këshilla për mirëqenien e një shtatzëne)

Shërbimi “Klasa për nëna”

Ky shërbim ofron mundësin që vajzat, gratë, çiftet, shtatzënat dhe lehonat të lajmërohen në dhomën për promovim shëndetësor dhe të informohen për: planifikimin familjar, për gjdhënien, për depresionin pas lindjes, për fazat e lindjes, për ushqyerjen e fëmijëve, ushqyeshmërin e shëndetshme gjatë periudhës së shtatzënisë etj.

Në këtë shërbim gjatë periudhës së parë të vitit 2025 në dhomën për “Promovim dhe edukim shëndetësor” kanë marrë shërbime gjithsej **107** qytetarë.

“Kujdesi në grup për Prindërim”

Ky shërbim mundëson edukimin e prindërve për rendësin e zhvillimit të hershem të fëmijëve dhe zhvillimin e aftësive prindërore të prindërve pjesëmarrës nëpërmjet pjesëmarrjes në sesionet grupore. Veçantia e këtij shërbimi është se organizohet gjithsej 7 sesione për secilin grup, ndërsa secili sesion i ka temat e veçanta sipas moshës së fëmijëve.

Gjatë periudhës së parë të vitit 2025 në dhomën për “Promovim dhe edukim shëndetësor” kanë marrë pjesë gjithsej 7 nëna me fëmijët e tyre, të shpërndara në **dy grupe**. Po ashtu janë bërë përgatitjet për formimin edhe të dy grupeve të tjera, njëri në muajin korrik dhe tjetri në muajin gusht.

Ofrimi i shërbimeve mjekësore për vizitat shtëpiak sipas marrëveshjes së Komunës së Vushtrrisë dhe Islamic Relief Worldwide me seli në Prishtinë.

Pozita profesionale	Numri i nëpunësve
Doktor të Mjekësisë	7
Infermier të Përgjithshëm	14
Teknik laborant	2
Asistent stomatologu	1

Raport 6 mujor i punës për projektin sipas marrëveshjes për ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kujdesi shtëpiak IRW-Komuna Vushtrri

Nr.	Periudha kohore	Numri total i vizitave	Meshkuj	Femra	Vizita Shtëpiake	Numri i vizitave të pacientëve mbi 65 vjeç	Numri i vizitave lehonave	Numri i vizitave të fëmijëve deri 3 vjeç	Shërbime në vizita shtëpiake	Totali i Shërbimeve
1	Janar	2130	947	1183	1294	971	45	110	2257	3227
2	Shkurt	2217	958	1259	1032	877	36	116	2041	5675
3	Mars	2070	888	1182	1148	867	35	111	2068	4611
	Totali, TM1	6417	2793	3624	3474	2715	116	337	6366	13513

4	Prill	3021	1202	181 9	1074	1111	28	91	1908	9503
5	Maj	2840	1156	168 4	1604	750	25	99	2062	10788
6	Qersh or	1837	707	113 0	1336	651	12	52	1382	4438
	Totali, TM2	7698	3065	463 3	4014	2512	65	242	5352	24729

Qendra për Punë Sociale

Asistenca sociale

Në QPS-së, Vushtrri në Asistencë Sociale janë 1017 familje, prej tyre 4261 anëtarë janë shqiptarë, si dhe 56 familje me 96 anëtarë janë minoritete.

Gjatë këtij viti janë parashtruar 15 kërkesa për asistencë sociale, prej të cilave 14 janë aprovuar kurse, 1 prej tyre është refuzuar si familje, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa, janë riaktivizuar 21 familje. Asistenca sociale i është ndërprerë 78 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale.

Në këtë periudhë raportuese kërkesa për ndihma momentale janë 1, e cila nuk është aprovuar.

Gjatë kësaj periudhe në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 613 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 605 aplikues, janë refuzuar 8 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 6.

Gjatë kësaj periudhe 13 familje i kanë kthyer mjetet, pasi që janë refuzuar nga ATK dhe janë të obliguar t'i kthejnë mjetet. Kthimi i mjeteve bëhet për shumën e marrë të ndihmës sociale për një muaj, kurse janë dorëzuar për Gjykatë gjithsej 16 lëndë, të cilat nuk e kanë bërë kthimin e mjeteve.

Gjatë kësaj kohe të raportimit janë shpërndarë ndihma në pako për shfrytëzuesit e ndihmës sociale përkrahur nga organizata të ndryshme, si Organizata Relief Islamic që ka shpërndarë 300 pako ushqimore me mish, si dhe Ambasada e Shteteve Arabe 200 pako ushqimore dhe 30 familje me veshmbathje.

Gjatë kësaj kohe, në kuadër të projektit SAS janë realizuar 581 vizita në familje. Ku, prej tyre kanë përfutur ndihmë 126 familje, si dhe janë pranuar 22 ankesa.

Shërbimet Sociale

Në periudhën raportuese krahasuar me vitin paraprak numerikisht numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të kategorive të reja dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e volumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale. Të gjitha këto konkretizohen përmes shënimeve të mëtutjeshme.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periode kemi pasur 32 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre 5 kanë arritur pajtim dhe 18 ndarje.

Nga këto familje janë 43 fëmijë, prej tyre 12 i janë besuar nënës në përkujdesje, ndërsa 2 ju janë besuar babait në përkujdesje.

Fëmijët pa kujdes prindor

Edhe në këtë periudhë QPS-ja detyrë prioritare ka pasur punën me fëmijët pa kujdes prindëror dhe në përgjithësi fëmijët nga familjet devijante. Është bërë evidentimi i këtyre fëmijëve, hapja e dosjeve dhe përpunimi profesional i kësaj kategorie deri në përfundim e sipër si punë permanente.

Kemi pasur 1 fëmijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar, kurse gjatë këtij viti kemi 2 fëmijë të braktisur, pra gjithsej 3 fëmijë, ku i janë ofruar këto shërbime. Pas qëndrimit në spital për një periudhë një mujore fëmijët janë regjistruar, ju është caktuar kujdestari ligjor; 1 rast i bartur nga viti i kaluar është adoptuar; 1 rast i braktisjes së këtij viti është vendosur në strehim familjar në komunitet deri në zgjidhje të statusit ligjor.

të tij, pastaj do të vazhdojmë me procedurat e adoptimit, 1 fëmijë pas qëndrimit disa ditë në spital dhe ofrimit të shërbimeve të nevojshme ka kaluar në bashkim familjar me nënën. Gjatë kësaj periudhe kemi 1 kërkesë nga Gjykata për vërtetim të atësisë.

Gjatë këtij viti i kemi pasur 4 kërkesa për kujdestari të veçanta, kemi caktuar kujdestar ligjor për 4 raste, me rastet e bartura nga vitet paraprake, gjithsej 18 kujdestari aktive. Strehim familjar 19 raste, 12 fëmijë janë në strehim familjar të afërmit dhe 7 fëmijë në strehim familjar në komunitet. Janë vizituar të gjitha rastet problematike, janë trajtuar në formën e duhur duke iu ofruar fëmijëve dhe familjeve seanca këshilluese, e shërbimeve të tjera të nevojshme, DPSF na ka njoftuar përmes trajnimeve të organizuara me OJQ, OFAP sipas nevojave të kërkuara nga QPS mund të ofrohen shërbime dhe trajtime në fushën e psikologjisë për fëmijët në strehim familjar të afërmit dhe në komunitet. Poashtu, kemi asistuar në gjykatë dhe kemi dhënë mendim, raport për 1 rast, martesë e të miturve.

Pra, krahasuar me vitin paraprak në periodën raportuese janë zbatuar në masë më të madhe format e mbrojtjes sociale si, vënia nën kujdestari të fëmijëve pa kujdes prindëror, 2 raste, 4 kujdestari për raste të veçanta, asistencë sociale si dhe shërbime të tjera të punës sociale. Ndihej në natyrë këtë vit krahasuar me atë paraprak ka qenë shumë e vogël me që është varur nga donatorët.

Të mitur me sjellje të çrregulluar dhe delikuent të mitur

Në këtë periudhë kemi këtë gjendje 13 raste të delikuentëve të miturve dhe 10 raste fëmijë në konflikt me ligjin, 3 raporte vlerësuese rreth gjendjes sociale për fëmijë të cilët kanë bërë kundërvajtje. Punëtorët e shërbimeve sociale asistojnë në polici dhe gjykatë për rastet e të miturve delikuent në përgjithësi. Për kategorinë e fëmijëve që bëjnë kundërvajtje japin raport vlerësues dhe propozues për masat ndëshkuese. Ndërsa për të miturit delikuent trajtimin dhe përpunimin e rasteve e bënë Shërbimi Sprovues të Kosovës, pra dhënie e mendimeve gjykatave, ndërsa në i trajtojmë edhe më tutje në aspektin e mbikëqyrjes. Në këtë drejtim me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në procesin e risocializimit dhe riedukimit kemi pasur bashkëpunim të drejtpërdrejtë me policinë, familjen, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe subjektet e tjera.

Veprat me të cilat karakterizohen të miturit me sjellje asociale janë bledhja, si rezultat i kësaj është prezencë edhe trafikimi i vajzave të mitura. Ndërsa delikuenca e të miturve karakterizohet më tepër me vepra penale, si vjedhje nga neni 135 LPK. Si dhe veprat prishje e rendit dhe qetësisë publike, drejtim i automjetit pa patentë shofer. Gjatë tretmanit psiko-social të këtyre fëmijëve dhe të miturve Qendra ka vendos kontakte permanente me të miturit, familjet apo kujdestarët e tyre si dhe bashkëpunim me subjekte tjera si OJQ, shkollat etj. Puna ka qenë e përqendruar në identifikimin gjegjësisht diagnostikimin e rastit, hulumtimin e personalitetit të fëmijut, identifikimin e interesave të të miturit dhe harmonizimin me normat e përgjithshme morale dhe juridike, organizimi dhe racionalizimi i kohës së të miturve, etj.

Viktima të trafikimit dhe tentim dhunimi

Gjatë periodes raportuese kemi 2 raste tentim dhunimi të të miturës, të cilat janë trajtuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe janë referuar për trajtim psikologjik pas trajtimit viktimë janë rikthyer në familjen e tyre, dhe 1 rast e mitur e shfrytëzuar për pornografi rasti është në procedurë. Në këtë vit nuk kemi raste të rriturave të cilat dyshohet për trafikim

Ekipi shërbimeve sociale në këto raste përcjellë këto viktima prej fillimit të hetuesisë në bashkëpunim me policinë, gjykatën, familjet dhe subjektet e tjera. Vlen të theksohet se nga QPS-ja në këtë vit janë ndihmuar rreth riintegrit 2 viktima të trafikimit nga vitet paraprake këto viktima të trafikimit kanë pasur edhe mbështetjen financiare me qëllim të rehabilitimit dhe reintegrit të tyre. Pra puna kryesore ka qenë e fokusuar në risocializimin, kthimin e tyre në familje dhe të rikthimit në shkollim të rregullt. Në këtë drejtim nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me qendrën e shëndetit mendor, kemi pasur raste të trajtuar nga kjo qendër dhe mendojmë se ka pasur sukses në stabilizimin e tyre psiko-social.

Dhuna familjare

Gjatë periodes që po raportojmë ka pasur shtim të rasteve ku kemi 14 raste të raportimit të dhunës familjare,

ndaj femrave dhe raste ndaj anëtarëve të familjes, çka është mjaft brengosëse kur të kemi parasysh se rastet po shtohen dhe ekipet e Qendrës për Punë Sociale duhet të jenë në gatishmëri dhe të ju ofrojnë asistim në polici, asistim në gjykatë, vendosje në strehim të përkohshëm, seanca konsultuese e këshilluese dhe bashkimin familjarë.

Në këtë vit kemi 2 gra dhe 1 vajzë, e cila është vendosur në strehimoren Raba Voca Mitrovicë. Dhe 1 rast të mbartur nga vitet e kaluara e vendosur në Shtëpinë e Sigurt Gjakovë.

Janë dhënë 14 urdhra mbrojtje prej gjykatës për rastet e dhunës në familje, 1 rastë kemi arritur ta pajtojmë 13 ndarje, ndërsa rastet e tjera janë në procedurë. Punëtorëve të shërbimeve sociale ju mbetet të vazhdojnë me trajtimin e këtyre rasteve në vitin vijues.

Personat e moshuar

Sikurse edhe kategoritë tjera të mbrojtjes sociale edhe këto kategori të moshës së pleqërisë kanë pasur tendencën e rritjes, mirëpo në këtë periudhë rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 5 raste 4 në shtëpinë e pleqëve Skenderaj dhe 1 në Prishtinë, 2 kërkesa të reja, 2 kërkesa janë në procedurë për tu vendosur në shtëpi të pleqve Prishtinë, dhe janë dhënë 9 raporte për bashkim familjar tek të afërmit jashtë shtetit.

Shtëpia Rezidenciale Lumadh

Në Shtëpinë Rezidenciale janë gjithsej 12 rezident.

Tani në muajin Qershor, ka përfunduar kontrata një vjeçare e konsulentit për Psikiatër, e cila ka qenë kontratë një vit kalendarik, i cili i ka kryer të gjitha shërbimet shëndetësore psikiatrike në Institucion. Meqë, ka përfunduar kontrata, jemi në konsultim me Drejtorinë e Prokurimit për një kontratë të re, pasi që rezidentët duhet me qenë patjetër nën kontrollin e Psikiatrit.

Kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Vushtrisë dhe Islamic Reliefin – Vizita shtëpiake për kontributin e dhënë në vazhdimësi të cilët kanë ardhur vazhdimisht kur ka qenë nevoja për ndonjë problem shëndetësor të Rezidentëve.

Kemi aplikuar punën në grup me rezident. Kjo metode e punës sociale kërkon një durim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm pasi që të gjitha veprimet e rezidentëve janë të pa koordinuara. Puna në grup ka për qëllim rritjen e shkallës së shkathtësisë sociale personale të rezidentëve që me punë dhe veprime të ndryshme të kërkohej që të arrihet qëllimi i caktuar i integritetit dhe bashkëpunimit me të mirë në rrethin social.

Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Gjatë periudhës janar – qershor të vitit 2025 në Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural janë zhvilluar këto aktiviteteve, aktivitete të bazuara kryesisht në planin e punës për vitin 2025 e të cilat po i paraqesim me poshtë në këtë raport.

1. Subvencioni i fermerëve për litër qumësht për periudhën janar-qershor 2024 me vlerë 78,756.60 nuk është bërë ekzekutimi i pagesave;
2. Subvencioni i fermerëve mbarështues të deleve, dhive dhe buallicave për vitin 2024 me vlerë 16,745.00 nuk është bërë ekzekutimi i pagesave;
3. Vendime për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, gjithsejtë vendime të lëshuara 29, me vlerë të përgjithshme 66,813.00.00€
4. Aplikimi i 1580 fermerëve për subvencione për pagesa direkt nga AZHB .

5. Subvencionimi i 127 fermerëve për bleje në vlerë prej 52,075.00 euro

Trajnimet me fermerë,

- a) Tuta Absolute të patatja- mënyra e luftimit të saj, pjesëmarrës -14
- b) Të shqyerit e lopëve qumështore gjatë laktacionit, pjesëmarrës -16
- c) Varietet e misrit me të përshtatshme për kushtet agroklimate të Kosovës, pjesëmarrës -20 fermer, dhe
- d) Herbicidet –mënyra e përdorimit të tyre në prodhimtarinë bimë, pjesëmarrës -20

Mund të themi se këto trajnime, kanë qenë më të mira që ndonjëherë janë mbajtur në Vushtrri. Të gjithë, pa përjashtim, nga trajnuesit, kanë qenë shumë të mirë. Numri i pjesëmarrësve (në të gjitha trajnimet) është 70 fermer. Gjithsej gjatë një viti, një këshilltar duhet të organizoj trajnime për 120 pjesëmarrës.

Janë furnizuar me fletushka informative bujqësore, në veprimtaritë e ndryshme bujqësore 130 fermer. Janë ndihmuar me këshillime dhe informata të ndryshme me dhjetëra fermer: për varietete të perimeve, për plehërime etj. Janë digjitalizuar dhe përkrahur për aplikim për subvencione 2025 mbi 500 fermer.

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar edhe vizita të shpeshta teke fermerët e komunës si dhe biznese bujqësore të komunës sonë me qëllim marrjen e informacioneve lidhur me sfidat që hasin fermerët dhe bizneset bujqësore tona.

Poashtu janë organizuar takime me fermer të komunës sonë si dhe me gra fermerë që merren me prodhimet e produkteve bujqësore.

Gjatë vitit në vazhdim janë të planifikuara projektet si subvencionimi i fermerëve që mbarështojnë bletë dele, dhi dhe buallica për vitin 2025.

Po ashtu janë të planifikuara edhe mbështetja për subvencionim të fermerëve për litër qumësht (pjesa janar – qershor 2025) dhe ujtja me 50% e sipërfaqeve të mbjella me kultura bujqësore.

Në realizim e sipër është edhe ndërtimi i tregut të gjelbër me bashkëfinancim me IRW, rregullimi i banesave të bardha, rregullimi i lumit Llap-Silnica si dhe projekti udha e gurit në bashkëfinancim me MZHR-në si dhe një projekt në implementim e sipër me IADK, Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të ardhurave në zonat rurale të Kosovës.

Shërbime Publike

Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë, prandaj mbështetur në planin e punës së kryetarit të komunës, ka përgatitur Raportin e punës për periudhën Janar-Qershor 2025. Drejtoria për Shërbime Publike bënë rregullimin e qytetit dhe mbrojtjen e ambientit, bënë mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të asfaltuara dhe të rendit të katërt, rregullimin e qarkullimit të komunikacionit, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, parkingjet, transportin lokal, përcjell largimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet publike, mbikëqyrje furnizimit me ujë të pijes dhe largimin e ujërave të zeza, menaxhon me procedurat e bartjes dhe deponimit të hedhurinave, pastrimin dhe larjen e rrugëve, shesheve dhe sipërfaqeve publike, mirëmbajtjen e shtratit të lumenjve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e varrezave, parqeve dhe gjelbërimit të qytetit, mbikëqyrje dhe menaxhon punën e autoparkut të Kuvendit Komunal, etj.

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar çdo ditë takime me stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, janë zhvilluar takime dhe biseda të shumta me Kompanitë Publike, përfaqësues të bashkësive lokale, fshatrave dhe lagjeve nga mbarë territori i Komunës, në lidhje me investimet në infrastrukturë qoftë nga Kuvendi Komunal qoftë nga pushteti qendror si dhe mundësinë e partisipimit nga ana e komunitetit. Është biseduar për problemet dhe nevojat me të cilat po ballafaqohen qytetarët, si dhe janë hulumtuar mundësitë reale të zgjedhjes së këtyre problemeve. Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve pas shqyrtimit në nivel të Drejtorisë,

janë dërguar në procedura të mëtutjeshme për vendosje, siç është Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës. Është konstatuar se nevojat dhe kërkesat e qytetarëve për rregullimin e infrastrukturës dhe problemeve tjera komunale, janë shumë të mëdha por për shkak të buxhetit të limituar dhe gjendjes jo të mirë ekonomike të vetë komunitetit, zgjedhja e këtyre problemeve është e vështirësuar.

Furnizimi me ujë

Sa i përket furnizimit me ujë të pijes, fabrika për prodhimin e ujit në Balinë ka vazhduar të operojë me orar të plotë 24 h në ditë. Është bërë rifunksionalizimi i pompave për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë për vendbanimet e pjesës lindore të komunës. Kemi vazhduar me implementimin e projektit për kycjen e ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit dhe funksionalizimin e pompave në fshatin Samadrexhë, Ropicë dhe Sfaracak, Studime, Dumnicë për të rregulluar furnizimin e këtyre lokaliteteve me ujë të pijes.

Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2025, janë zhvilluar punimet për implementimin e kontratave dy vjeçare për ndërtimin e kanalizimit në fshatrat; Maxhunaj Studime, Dumnicë, Beqok, Stroc, Mihaliq, Stanoc i Poshtëm, Akrashticë. Ndërsa është bërë ç'bllokimi i një numri të konsiderueshëm të gypave dhe pusëve të bllokuara, si fsh. Dobërllukë, rr. Adem Ademi në Vushtrri, rr. „Avdulla Nika” dhe një numër të konsiderueshëm të rrjetit të kanalizimit.

Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së drejtorisë, me planin financiar, është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pusëve të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen Përparimi.

Menaxhimi i Mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, patë themeluar grupin teknik për hartimin e planit ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave brenda regjionit, i cili plan është hartuar dhe pritët miratimi i tij deri në fund të vitit. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1500 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh.. Qendra për paketim në Bukosh, tashmë është në menaxhim të Ndërmarrjes Përparimi. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale si deponia në fshatin Bajskë dhe aktualisht i kemi vetëm pesë deponi të tilla.

Si rezultat i këtij angazhimi ndërmarrjes „Përparimi” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit. Është ky viti i tretë prej themelimit të Ndërmarrjes Lokale „Përparimi”, përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve si dhe është bërë mbjellja e luleve dekorative, mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimit publik. Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMM Raporti për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2024, si dhe Plani Ndërkomunal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.

Ndriçimi publik

Ka vazhduar implementimi i kontratës – marrëveshjes për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit publik, implementimin e së cilës është duke u bërë nga Ndërmarrja Lokale „Përparimi”

Komunikacioni

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me auto merimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio Taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim shkarkim.

Në fushën e trafikut është hartuar paramasa dhe parallogaria për mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët e qytetit dhe emërtimet e vendbanimit, me qëllim të krijimit të një rrjeti funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pa motorizuara, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta, ndërsa është formuar grupi teknik që në bashkëfinancim me UN – HABITATIN të bëjmë hartimin e planit të mobilitetit sipas Marrëveshjes së nënshkruar në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Vlera e projektit është 100,000.00 € prej të cilave 80% do të financohen nga UN- HABITAT. Gjithashtu është shpallur konkursi për ndarjen e linjave të transportit urbano-periferik në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Gjatë periudhës së parë të vitit, ka vazhduar mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara përmes kontratës për rikonstruim dhe mirëmbajtje të rrugëve, me ç'rast janë riparuar mjaft segmente rrugore me asfalt dhe me kubza dhe të një numri të konsiderueshëm të pusetave dhe ndërrim të gypave të kanalizimit. Gjithashtu janë hartuar të gjitha paramasat dhe parallogaritë për iniciimin e procedurave për ndërtimin e rrugëve me kubza betoni si dhe ndërtimin e trotuareve.

Kulturë Rini dhe Sport

QENDRA E KULTURËS “HASAN PRISHTINA”

Bazuar në Planin e Punës për vitin 2025, në Qendrën e Kulturës "Hasan Prishtina" punët kanë rrjedhë sipas planit, duke realizuar në tërësi planin e punës, por duke e plotësuar atë edhe me aktivitete të reja shtesë, të cilat ndonëse nuk janë paraparë në planin e punës, kanë dalë si rezultat i ideve të reja të stafit të drejtorisë sonë, apo edhe qytetarëve që janë marrë me aktivitete kulturore, por edhe institucionet tjera me të cilat kemi bashkëpunuar gjatë këtij viti.

Në aktivitetet e zakonshme që i organizojmë si drejtori, por edhe aktivitete tjera të organizuara qoftë nga Kryetari i Komunës, Drejtorja e Arsimit, Drejtorja e Diasporës apo edhe sektorët e tjerë përbrenda DKRS-së ne kemi qenë të angazhuar në mbarrëvajtjen e atyre organizimeve, qoftë në mbështetje teknike me mjete të zërimit apo edhe mjete tjera teknike.

Ndër aktivitetet kulturore që kemi organizuar apo që kemi marrë pjesë në organizim veçojmë:

Akademi Solemne për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;

Organizimi i aktiviteteve për Epopenë e UÇK-së “Nata e zjarreve” me ushtarë të UÇK-së në fshatin Stroc;

Akademi Përkujtimore "Studimja '99";

Akademi Përkujtimore për nder të përkujtimit të masakrës së 22 Majit në Vushtri;

Akademi Përkujtimore për Masakrën mbi Familjes Gërxfaliu;

Aktivitetet dhe koncert për fëmijë për nder të Ditës së Fëmijëve - 1 Qershor 2025;

Akademi Solemne për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë – 17 qershor 2025;

Ceremonia e diplomimit të gjimnazistëve vushtrrias;

Organizimi i Festivalit “Zëbylbylat e Vicianës”;

Akademisë Solemne për Ditën e Pavarësisë së Kosovës me 17 Shkurt 2025;

Ditën e Çlirimit të Vushtrrisë me 17 Qershor 2025.

Mbështetja e të gjitha shkollave dhe kopshteve që janë drejtuar për organizimet e fund vitit shkollor, kryesisht festimi i përmbylljes së ciklit parashkollor, përmbylljes së klasës së parë apo Ditës së Abetares dhe klasat e pesta, si dhe mbështetja në përrurimin e librave të ndryshëm që është organizuar kryesisht nën patronazhin e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë.

Ne kishim bërë përgatitjet për realizimin e një koncerti në Kapfenberg të Austrisë, por për shkak të një sulmi terrorist që kishte ndodhur atje ishte shpallur ditë zie në Austri dhe për atë arsye janë anuluar aktivitetet kulturore dhe rrjedhimisht është anuluar edhe vizita e AKV “Hasan Prishtina” në Vjenë.

Drejtori i QK "Hasan Prishtina" ka qenë edhe në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim të botimeve dhe publikimeve, ku janë mbështetur dhjetëra botime të reja të autorëve vushtrrias, por edhe në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave të tjera për subvencionim, të cilat nuk kalojnë shumën mbi 500 euro, bazuar në rregulloren e MF për ndarjen e subvencioneve, si dhe në komisione tjera për vlerësim të projekteve të DKRS-së.

BIBLIOTEKA "NAIM FRASHËRI"

Librat më të kërkuara për lexim gjatë kësaj periudhe ishin :

-**Sektori për fëmijë:** "Lutjet e mbrëmjes" autor Anton Pashku, "Kalamajtë e pallatit tim" autor Bedri Dedja, "Tregime të moçme shqiptare" autor Mitrush Kurteli, "Albumi" autor Fan.S. Noli, "Verorja" autor Rexhep Hoxha;

-**Sektori për të rritur:** "Hamleti", autor Shekspiri, "Historia e Skënderbeut", autor Marin Barleti, "Dr. Gjilpëra", autor Faik Konica, "Kështjella", autor Ismail Kadare, "

- **Libri Shkencor:** "E drejta romake" Bedri Bahtiri, "Komedi hyjnore" Dante Aligeri dhe "Historia e Skenderbeut" Marin Barleti;

Aktivitetet e punës në sektorin e bibliotekës së qytetit:

- Në sektorin për fëmijë, gjatë kësaj periudhe janë dhënë 2636 libra për lexim.
- Në sektorin e të rriturve, gjatë kësaj periudhe janë dhënë për 1636 lexim libra.
- Sallën e leximit e shfrytëzuan 747 lexues.
- Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 146 lexues të ri, për fëmijë 116 lexues, për të rritur 30.

Gjatë periudhës janar deri më 30 qershor 2025 janë përpunuar gjithsej 470 libra, janë inventarizuar 790 libra, janë siguruar 920 libra, janë vendos etiketa në 590 libra, janë vulos 1530 libra.

- Aktivitete tjera: U mbajt Tryezë shkencore kombëtare me temën: "Udhërrëfyesit emblemantikë të UÇK – 28 vjet nga rënia e Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut.
- Gjatë kësaj periudhe janë dhuruar libra nga autor të ndryshëm.
- U shënua 17 Shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës, ekspozita "Qyteti i Vushtrrisë" foto nga Nesim Spahiu.
- Me datë 21.02.2025, bibliotekën e qytetit e vizituan fëmijët e IP"Foleja", dy grupe të parashkollorëve së bashku me edukatorët e tyre.
- **Përrurim i librave:**
- Përrurimi i librit "Femra shqiptare- Roli dhe sakrifica për atdhe" të autores Ymrije Beqiri;
- Aktivitet: Përrurimi i librit "Trimi i lirisë Behram Rrahmani – Monografi i autores Remzije Zekolli;
- Janë bërë përgatitjet për të shënuar ditën e bibliotekës;
- Vizitë pune në paralelen e ndarë në Studime të Poshtme;
- Vizitë në bibliotekë, tri paralele të nxënësve të klasave të teta të SHMU/2 bashkë me arsimtarin e tyre;
- Libra të kërkuara nga lexuesit që nuk i posedon biblioteka: "Femra shqiptare", autore Ymrije Beqiri
- Gjatë këtij muaji është shënuar 2 Prilli - Dita Botërore e Librit për Fëmijë, është mbajtur debat me shkrimtarët Zymer Mehani, Enver Sahiti, Fatmir Çitaku, Sadriu Rexhepi, Teuta Kadriu dhe Ymrije Beqiri.
- Janë bërë përgatitjet për shënimin e 23 Prilli- Dita Ndërkombëtare e Librit;
- Me datë 23 Prilli 2025 biblioteka e qytetit organizoi program për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Librit;

Gjatë muajit prill, Bibliotekën e qytetit e vizituan, nxënës , poet, e krijues të shumtë.

MUZEU HISTORIK – ETNOGRAFIK

Gjatë periudhës janar – qershor 2025, Muzeu ka realizuar aktivitetet e rregullta administrative dhe profesionale, përfshirë:

Hartimin dhe dorëzimin e raporteve javore për aktivitetet dhe punët e kryera;

Përgatitjen e raportit vjetor për punën e realizuar gjatë vitit 2024, duke përmbledhur të gjitha aktivitetet muzeale, ekspozitat, punët kërkimore dhe bashkëpunimet institucionale.

Në kuadër të punës hulumtuese në terren janë identifikuar dhjetëra e qindra eksponate të ndryshme nga fusha e etnologjisë, të punuara me motive gjeometrike dhe florale.

Në kuadër të këtyre hulumtimeve, janë identifikuar edhe qindra fotografi të vjetra me vlerë të madhe historike dhe kulturore.

Gjatë kësaj periudhe, Muzeu i Vushtrrisë është pasuruar me mbi 250 eksponate nga materiale të ndryshme, të dhuruara nga familje të ndryshme të komunës së Vushtrrisë. Dhurimet më të mëdha u realizuan në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të themelimit të Muzeut të Vushtrrisë, ku:

Znj. Dinore Curri dhuroi 100 eksponate etnologjike me vlerë të veçantë kulturore dhe historike;

Z. Nesim Ispahiu dhuroi mbi 100 aparate fotografike, me të cilat kishte punuar ndër vite, duke kontribuar kështu në pasurimin e sektorit të etnologjisë dhe historisë së fotografisë.

Sektori i fototekës në Muzeun e Vushtrrisë është pasuruar me mbi 300 fotografi të vjetra familjare, të cilat dokumentojnë jetën dhe traditat e familjeve të Vushtrrisë. Këto fotografi janë realizuar kryesisht në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, dhe përbëjnë një pasuri të çmuar vizuale dhe historike për fondin muzeal.

Biblioteka e Muzeut të Vushtrrisë posedon rreth 500 libra.

Në kuadër të punës së brendshme muzeale, janë inventarizuar rreth 90 eksponate që i përkasin kulturës materiale.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Muzeu i Vushtrrisë ka organizuar një sërë aktivitetesh me fokus në promovimin, edukimin dhe vetëdijesimin e gjeneratave të reja, përmes komunikimit muzeor dhe përfshirjes së tyre aktive në procesin e njohjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

Disa nga aktivitetet e realizuara përfshijnë:

Ekspozita “Vushtrria e Vjetër”

Dita Ndërkombëtare e Guidave Turistike

Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit – Kosova 2025

Dita Ndërkombëtare e Muzeve

Trajnim për të rinjtë në fushën e fotografisë digjitale.

1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.

20 – vjetori i Muzeut të Vushtrrisë (9 qershor 2025). Përvjetori u shënua me një program të pasur kulturor.

SEKTORI I SPORTIT

Palestra e Sporteve Jeton Tërstena – Tota përdoret nga shumica e klubeve të regjistruara në Komunë dhe Federata gjegjëse si klube sportive, në këtë palestër përveç stërvitjeve, organizohen/luhen ndeshjet kampionale në shumë sporte, përveç shfrytëzimit të terminëve nga klubet palestra ndonjëherë shfrytëzohet edhe me pagësë në harmoni me rregulloret e parapara. Po ashtu në këtë palestër zhvillohen edhe garat shkollore të cilat organizohen nga Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit.

Klubet të cilat e shfrytëzojnë palestrën janë:

Klubi i Hendbollit – Meshkujt – Vushtrria

Klubi i Hendbollit - Femrat – Vushtrria

Klubi i Basketbollit – Meshkujt – Vushtrria

Klubi i Basketbollit – Femrat – Vushtrria

Klubi i Basketbollit M – Vushtrria Basket
 Klubi i Volejbollit – Femra – Vushtrria
 Klubi i Volejbollit – Meshkujt – As Vushtrria
 Klubi i Volejbollit – Femrat - As Vushtrria
 Klubi i Basketbollit – M – Gjinnazisti
 Klubi i Boksit - M – Kalaja
 Klubi i Boksit – M – Vushtrria
 Klubi i Gjinnastikës – Meshkuj/Femra – Vushtrria
 Klubi i Pingpongut - Meshkuj/Femra – Hasan Prishtina
 Klubi i Pingpongut – Meshkuj/Femra - Vushtrria

Është organizuar turneu në basketboll (Streetball). Ekipet pjesëmarrëse kanë qenë katër (4). Në komunën tonë janë të regjistruara (34 klube ,shoqata). Sukseset e klubeve të Vushtrrisë për këtë edicion garues.

KLUBET SUPERLIGES

1. KLUBI FUTBOLLIT “VUSHTRRIA “ ka humbur mundësin që të bëhet anëtar i super ligës për këtë sezon dhe prapë ka mbet në Ligën së Parë të Futbollit.
2. KLUBI HENBOLLIT “VUSHTRRIA” (M) ka arritur që të jetë në super ligën e Kosovës.
3. KLUBI HENBOLLIT “VUSHTRRIA”(F) është shpallur nën kampion Super ligës për edicionin 2022/2023 dhe ka të drejtë përfaqësimi në arenën ndërkombëtare.
4. KLUBI HENBOLLIT “ SAMADREXHA” (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë.
5. KLUBI HENBOLLIT “ SAMADREXHA” (F) ka garuar në Super ligë , dhe ka ruajtur statutin e Super ligës duke arritur që të jetë edhe pjesëmarrëse në garat ndërkombëtare.
6. KLUBI BASKETBOLLIT “VUSHTRRIA” (M) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka ruajtur statutin e Ligës së Parë.
7. KLUBI BASKETBOLLIT “VUSHTRRIA BASKET” (F) ka garuar në Ligën e Parë dhe ka arritur që të jetë në vendin e tretë, gjatë këtij edicioni garues .
- 8.KLUBI VOLEJBOLLIT “ASVUSHTRRIA” (M) ka garuar në Super ligë , dhe ka mbetur në vendin e fundit në edicionin garues.
9. KLUBI VOLEJBOLLIT “AS VUSHTRRIA” (F) ka garuar në Ligën e Parë , dhe ka arritur që të jetë në vendin e parë në Ligen e Parë Lindje, për këtë sezon.
- 10 . KLUBI VOLEJBOLLIT “VUSHTRRIA” (F) ka garuar në superlige , dhe ka arritur të ruaj këtë pozitë në Super ligën B.

KLUBET E KATEGORIVE TË REJA

- 1.KLUBI FUTBOLLIT “ VUSHTRRIA “ Kampion U 18 , Liga Regjionale.
2. KLUBI FUTBOLLIT “ VUSHTRRIA” Kampion U 17 , Liga Regjionale.
3. KLUBI FUTBOLLIT “EL CLASICO “ Fitues i Kupës U 17 , Liga Regjionale .
4. KLUBI FUTBOLLIT “ FORCA “ Vendi I Dytë (2) , Liga Regjionale.
5. KLUBI VOLEJBOLLIT “ AS VUSHTRRIA “ Finalist , U 18 , U 1

SEKTORI I RINISË

Përgatitja e planit të punës për sektorin e Rinisë për vitin 2025.

Së bashku me Qendrën Rinore, OJQ-të, dhe grupet joformale u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2025.

Në bashkëpunim me bordin e KVRL-së, u diskutua dhe planifikua për projektet që do të realizohen gjatë vitit 2025, po ashtu u diskutua edhe për rristrukturimin i këtij këshilli që do të bëhet gjatë këtij viti.

Janë njoftuar të gjitha OJQ-të rinore, KVRL-ja, Qendra Rinore si dhe grupet jo formale të të rinjve për thirrjen publike për mbështetje financiare nga Komuna, po ashtu janë njoftuar edhe për thirrjet nga MKRS-ja, njëherit do tu ofrohet mbështetje profesionale dhe administrative, aq sa do të jetë e mundshme në kapacitetet tona.

Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OJQ-ve rinore gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi dhe janë hartuar projekt propozime dhe janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe IOM dhe OSCE.

Takime pune dhe bashkëpunim me OSCE, ku janë plotësuar disa pyetësor që janë dërguar nga ta edhe njëherë OSCE ka shpreh gatishmëri që të bashkëpunojë në aktivitete të ndryshme në fushat të cilat mund të na ndihmojë OSCE-ja.

Është licencuar Qendra Rinore bazuar në Ligjin Nr. 08/L-264 për Rini si dhe Udhëzimin Administrativ (MKRS) Nr. 11/2024 për Qendrat Rinore, pas procedurave administrative është licencuar Organizata Rinore "Hareja".

Organizata Rinore "Access" në bashkëpunim me sektorin e rinisë dhe Departamentin e Rinisë – MKRS ka planifikuar që të organizojnë trajnime për të rinjtë në komunën e Vushtrrisë, është hartuar projekt propozimi dhe do të dërgohet për financim.

Takime pune me përfaqësuesit e Strategjia Rinore dhe KVRL-së ata kanë, shprehur vullnet për të hartuar një projekt për hartimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal, Në fund të këtij projekti do të hartohet PVRL për tri vitet e ardhshme.

Takim me përfaqësuesin e OJQ "Kosova Serwas" me të u diskutua për projektet që parasheh të realizojë kjo OJQ, për formën e aplikimit dhe qasje në fonde të donator të ndryshëm.

Është në realizim e sipër projekti "Të rinjtë në vendimmarrje" ky projekt realizohet nga Komuna e Vushtrrisë. Gjysma e pare e projektit është realizuar ndërsa ky projekt do të vazhdojë edhe me gjysmën tjetër, realizimi i këtij projekti do të ketë një impakt të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore.

KVRL në bashkëpunim me organizatën "Domain for Kosovo" kanë mbajtur sesion informues për të rinjtë në shkollat e mesme, ky sesion ka për qëllim informimin e të rinjve për themelimin dhe punën e KVRL-së si dhe promovimin e Domenit shtetëror për Kosovë.

Trajnime për shkathhtësi të buta, kurse për kompjuter, kurse për gjuhë të huaja, kurse për matematikë, të mbajtura nga Qendra Rinore "Hareja" e cila është licencuar në fund të vitit të kaluar

Qendra Rinore "Hareja" në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë dhe organizatën Gjermane DVV, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për 3 vite, ky memorandum parasheh Aftësimin Profesional për të rinj dhe të rritur në disa fusha, Gjuhë të huaja, TIK, rrobaqepësi dhe kurse tjera çfarëdo që shprehin interes grupe të caktuara për të u trajnuar.

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik është institucion i cili pranon, evidencon, rregullon dhe publikon lëndën arkivore, mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për organet, organizatat, institucionet, personat civil-juridik.

Arkivi kryen veprimtarinë konform ligjit dhe akteve të përgjithshme juridike, ky institucion punët i kryen nëpërmjet këtyre shërbimeve:

- Shërbimi për mbrojtjen e lëndës arkivore brenda dhe jashtë arkivit

- Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet lokale

- Evidentimi dhe rregullimi dhe klasifikimi i dokumenteve arkivore brenda arkivit

- Aktivitete tjera

- Punët e depos, mirëmbajtja, renditja si dhe mbikëqyrja e dokumentacionit

- Punët e udhëheqjes në arkiv

- Aftësimi profesional i punëtorëve

Në periudhën janar- qershor 2025 jemi konsultuar vazhdimisht me Drejtoritë komunale të cilat kanë dorëzuar material arkivor në vitin 2023 për regjistrimin dhe finalizimin e dosjeve të cilat janë të përhershme.

Materiali është dorëzuar në Arkiv për shkaqe emergjente për lirimin e hapësirës në depon e materialit në Komunë për renovim të saj. Materiali i pranuar është në gjendje të mirë , por i pa sistemuar në mungesë të rafteve arkivore.

Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pranuar material nga institucionet lokale, nga Drejtoria e Urbanizmit , projektet e viteve 2015-2019.

Drejtoria e Administratës librat e regjistrit për vitet 2018-2024 totali i regjistrave 65 .

Gjatë kësaj periudhe janë parashtruar 32 kërkesa të ndryshme: pronësore, përvojë të punës, verifikime të diplomave të ish-shkollës së policisë e cila ka funksionuar para vitit 1999.

Bashkëpunimi për digjitalizim me komunën e VAXJO- Suedi po vazhdon sipas planit , gjatë vizitës së tyre në muajin prill 2025 kemi prezantuar Arkivin dhe institucionet tjera nga grupi punues.

Arkivi në bashkëpunim me grupin për digjitalizimin e arkivit apo shërbimeve komunale kemi hartuar dokumente në lidhje me shërbimet komunale ..

Angazhimi në komisione për vlerësim të ofertave të prokurimit, rekrutimit të zyrtarëve komunal si dhe angazhimi për menaxhimin e kontratave për projektet në kuadër të DKRS-së, ishin sfida pothuajse kryesore , pasi që shumë elemente të fushës së prokurimit janë jashtë fushës për të cilën jemi të emëruar. Gjatë kësaj periudhe kohore në muajin shkurt 2025 është plotësuar vendi i lirë i punës me një zyrtar arkivist, tani Arkivi është plotësuar me staf të mjaftueshëm (shefi i sektorit dhe tre arkivist).

Angazhimi i zyrtarëve të arkivit në komisione për subvencionimin e librave , klubeve dhe OJQ-ve.

Në arkivin e qytetit gjatë kësaj periudhe kohore është bërë rekrutimi i një zyrtari-arkivisti i cili është pranuar si punëtor i rregullt dhe kryen shërbime në kuadër të arkivit.

TEATRI I QYTETIT "ADEM MIKULLOVCI"

Ne muajin janar kemi filluar realizimin e shfaqjes “Burri Burrë”, të autorit Kristo Floqi, në regji të Fazli Muharremi. Premiera e kësaj shfaqjeje është realizuar më 12 mars 2025.

Realizimi i Akademisë Përkujtimore për Komandant Gani Imerin

Ishim bashkë organizator ne Ditën Ndërkombëtare të Librit të organizuar nga Biblioteka Naim Frashëri

Në organizimin e Festivalit Zëbylbylat e Vicianës ne si teater kemi reliazuar posterin iden dhe realizimin e këtij eventit me 25 prill 2025.

Me 2 maj 2025 organizuam Akademi në përkujtim të Masakrës së Studimes.

Me 22 maj 2025 organizuam Akademi në përkujtim të Masakrës së Vushtrrisë

Me 31 maj u përkujtua Selatin Gerxhaliu me familje ,

Për nder të ditës së Çlirimit 17 qershorit teatri u angazhua ne këtë organizim

Inspekcioni

Drejtoria Për Inspektime në Komunën e Vushtrrisë gjatë kësaj periudhe kohore me rastin e ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse, aktivitetet inspektuese i ka përqendruar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira operatorëve ekonomik në aplikimin e dispozitave ligjore dhe ushtrimin e veprimtarive

Në kuadër të Drejtorisë për Inspektime veprojnë Inspektorë të fushave të ndryshme, andaj raportin vjetor të punës po e paraqesim në mënyrë të detajuar për secilin sektor janë paraqitur aktivitetet sipas fushave të bazuar në planin e punës për vitin 2025.

Sektori i Inspektoratit	Numri i Inspektorëve	Procesverbale	Aktivendime	Mbyllje të lokaleve përkohsishtë	Gjaba mandatore të realizuara	Urdhëresa
Inspektorati i Tregut	3	42	-	-	5	-
Inspektorati i Ndërtimtarisë	1	37	8	/	3	-
Inspektorati i Komunikacionit	2	57	36		19	20
Inspektorati i Shërbim Publike	4	32	7		7	12
Inspektorati për Mbrojtje të Mjediist	1	16	-	-	3	-
Totali	11	184	51	-	37	32

Inspektorati i tregut

Inspektorati i Tregut me qëllim të mbrojtjes të konsumatorit mbi të drejtat që ju garanton Ligji Për Mbrojtjen e Konsumatorit, janë kryer inspektime të rregullta në subjekte afariste ndërsa për parregullsitë të hasura në subjektet afariste janë ndërmarr masa administrative për eliminimin e parregullsive .

Gjatë kësaj periudhe janë inspektuar subjekte ekonomike :

- subjekte afariste ku frekuentimi i konsumatorëve është më i madh
- subjekte afariste me të vogla që shesin mallra ushqimore
- subjekte afariste që shesin mallra jo ushqimor
- Subjektet afariste hoteliere, shërbyese
- Subjektet ekonomike lidhur me respektimin e orarit të punës të përcaktuar me Rregullore Komunale.
- Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve.
- Subjektet ekonomike të cilat merren me transportimin e mallrave, lidhur me dokumentacionin përcjellës për mallrat e tregtuar.

NDËSHKIM ME GJOBË

Bartës i aktivitetit - Inspektorati i Tregut

Subjekte të gjobitura	5
Të hyra nga gjobat	1,600.00

Ankesat të drejtuara Inspektoratit				
Ankesat e përgjithshme	Në favor të konsumatorit	Të zgjedhura	Të pazgjidhura	Ankesat e shqyrtuara në %
7	5	5	-	100 %

SUBJEKTE AFARISTE TE PAJISURA ME PËLQIM MBI PLOTËSIMIN

KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE

Bartës i aktivitetit - Inspektorati i Tregut

APLIKUAR	62
TË VENDOSURA	49
TË REFUZUARA	7
NË PROCEDURË	6
Mjete të inkasuara në €	9,635.00 €

Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit

Gjatë kësaj periudhe kemi ndërmarrë një sërë aktivitete në lëmin e mbrojtjes së mjedisit me qëllim të krijimit të një mjedisi më të pastër, më të sigurt dhe më të shëndosh për të gjithë qytetarët. Për realizimin e këtij qëllimi kam bërë analiza në lëmin e ndërgjegjësimit ambiental dhe edukimit me qëllim të krijimit të gjitha mekanizmave dhe të instrumenteve të mundshme që nevojiten për të krijuar një program të përhershëm për vetëdijësim dhe edukim mjedisorë.

Në gjashtëmujorin e parë të viti 2025 janë lëshuar 16 procesverbale kryesisht ndërtuesve për eliminimin e mbeturinave para objekteve ku është duke u bërë ndërtimi si dhe për respektimin e lejeve mjedisore komunale.

NDËSHKIM ME GJOBË

Subjekte të gjobitura	3
Të hyra nga gjobat	535.00 €

Gjatë kësaj periudhe kam pasur bashkëpunim të ngushtë me Inspektorët e sektorëve tjera, KRU "MITROVICA" njësi në Vushtri, NPL "PËRPARIMI", Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

Andaj për t'i ikur ndonjë rreziku kemi intervenuar me njësinë e zjarrfikëseve për ta ulur temperaturën e rezervuarëve.

Është bërë përcjellja e punëve të NPL "PËRPARIMI" në Vushtri gjatë pastrimit, larjes dhe freskimit të rrugëve të qytetit.

Kam ndërmarr edhe aktivitete tjera mjedisore sipas rastit që janë paraqit në teren

Kam ndërmarr edhe çfarëdo detyre tjetër që është kërkuar nga Drejtori i Drejtorisë

Inspektorati i komunikacionit

Për këtë periudhë kohore kemi lëshuar: procesverbale, vendime për pranime teknike të autotaksive, vendime për gjoba mandatore, ku dhe janë inkasuar mjete bazuar në vendimet.

Me qëllim të përmirimit të gjendjes së transportit rrugor në teritorin e Komunës së Vushtrrisë janë marrë masa konform dispozitave ligjore si dhe inspektimet janë kryer në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Stacioni në Vushtri:

Qëllimi i inspektimit është Mbikqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarve dhe mallrave, që qarkullojnë në teritorin e Vushtrrisë:

- Inspektimi i Autotaksive;
- Operatorët "Taksi";
- Ndermarrjet të cilat mirren me transport të udhëtarve;
- Ndalimi i operatorve ilegal, masat e ndermarura ndaj tyre;
- Kushtet teknike të automjeteve;
- Inspektimin e automjeteve të transportit të mallrave;
- Kontrollimin e vijave Komunale urbane dhe urbano-periferike.

Pranimi teknik i automjeteve

APLIKUAR	17
TË VENDOSURA	17
NË PROCEDURE	-
Mjete të inkasuara në €	170.00€

Aktivitetet të paraqitur në mënyrë tabelare

Inspektorati	Nr. i kërkesave	Aktivitete Inspektuese	Procesverbale	Urdhëresa	Aktvendime	Gjoba mandatore
Inspektorët e Komunikacionit	17	132	57	20	36	19

Inspektorati i shërbimeve publike

Aktivitetet:

- Inspektimi i hapësirave publike – ekspozimi i mallrave jashtë lokaleve, në trotuare dhe sheshe,
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave,
- Vazhdimi i lëndëve sipas afateve kohore të dhëna nga Inspektorët,

Inspektimi në bazë të Planit të Punës është bërë kryesisht në rrugën “Ismail Qemajli”, sheshi “Hasan Prishtina” dhe sheshi “Adem Jashari”. Përveç aktiviteteve në bazë të planit të punës, kemi bërë edhe inspektimin në pjesë të tjera të qytetit sipas nevojës, në bazë të detyrës zyrtare, me sugjerim të Drejtorit të Drejtorisë për Inspektime.

Përveç inspektimeve, te angazhimet tjera hyjnë edhe vendimet për inspektimet e kryera dhe raportet e vazhdueshme rreth punës.

Forma tabelare

Procesverbale	32
Vendime	7
Gjoba	7

Me qëllim të realizimit të detyrave jemi angazhuar dhe kemi bashkpunuar me Inspektorët e Tregut dhe inspektorët tjerë varsisht nga aktivitetet e kërkuara dhe me kërkesën e Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit. Nga inspektimet dhe konstatimet janë hartuar 32 procesverbale, 12 urdhëresa dhe 7 gjoba mandatore.

Inspektorati i Ndërtimit

Për këtë periudhë janë kryer inspektime lidhur me ndërtimet e objekteve të ndërtimit të lartë dhe të ulët, duke kontrolluar terrenin e komunës së Vushtrrisë, ndërprerjen e të gjitha ndërtimeve pa leje, kontrollimin e objekteve me leje ndërtimi, rrënimin e objekteve pa leje.

Për të ardhur deri te një analizë sa më e saktë e punëve kemi bërë grumbullimin e të dhënave për aktivitetet a planifikuara dhe atyre të realizuara, duke nxjerrë statistika e deri te rekomandimet për të rritur efikasitetin në punë.

Aktivitetet e implementuara

- Në kuadër të kontrollimit të terrenit, janë përpiluar procesverbalet dhe Aktvendime për ndërtimet me leje ndërtimi dhe ato pa leje ndërtimi.

- Ndërprerja e ndërtimeve pa leje ndërtimi, ndalimi i punimeve është urdhëruar me afat kohor menjëherë si dhe janë vendosur shirit rrethues të cilët ndalojnë punimet pa leje deri në pajisjen me dokumentacion përkatës të lejes ndërtimore, shumica e ndërtimeve pa leje janë shtëpi banimi, por ka edhe objekte afaristë.
- Kontrollimi i objekteve me leje ndërtimi,

Procesverbale

Procesverbalet janë lëshuar për ndërtimet të bëra pa leje ndërtimi dhe pa pëlqime urbanistike, kryesisht për ndërtime të banimit individual, por ka pas edhe raste të ndërtimeve për të cilat kërkohen pëlqimet urbanistike, siç janë: te rrasat para objekteve, ndryshimet në objektet ekzistuese me leje ndërtimi, ndryshimet në kulmet e objekteve dhe në fasadat e tyre.

Vendime për ndërprerjen e ndërtimeve pa leje ndërtimi

Vendimet për ndërprerje të punimeve janë lëshuar për objektet që kërkohet leja e ndërtimit por të cilat nuk janë pajisur me leje ndërtimi, vendimet për ndërprerjen të punimeve kanë karakter të urdhëresës së prere për ndërprerje të punimeve deri në pajisje me leje ndërtimi.

Gjoba mandatorë

Gjobat mandatorë janë lëshuar në bazë të udhëzimit administrativ për shqiptimin e gjobave mandatorë, për ndërtimet e bëra pa leje dhe pjesëmarrësve në ndërtim si dhe në mbështetje të Ligjit për Kundërvajtje 05/L-087 të cilët kanë punuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me ndërtimin e objekteve.

Takimet me palë /

Sfidat

Pavarësisht mbarëvajtjes së punës, në Drejtorinë për Inspektime kemi hasur edhe në sfida të ndryshme të cilat kanë penguar rrjedhën normale të punës, ndër sfidat kryesore të evidentuara janë:

- Mungesa e Planifikimit Hapësinor dhe Planeve Rregulluese të hollësishme, në shumicën e zonës mungojnë planet rregulluese po ashtu pa përputhshmëri e planeve me gjendjen faktike në terren, mangësi të tilla detyrojnë qytetarët të ndërtojnë objekte pa leje ndërtimi.
- Vonesat procedurale në lëshimin e lejeve ndërtimore,
- Pamundësia për tu pajisur me leje ndërtimore (mungesa e Planeve Rregulluese, zona nën komasacion, problemet pronësore, etj.), propozojmë që kuvendi komunal të hartojë rregullore komunale për lehtësimin dhe tejkalimin e këtyre sfidave,
- Nevoja për banim (rritja e familjes, shtimi i numrit të të martuarve, nevoja për banim më të qëndrueshëm),
- Kërcënimet dhe sulmet e vazhdueshme ndaj stafit, mungesa e mbështetjes shëndetësore dhe financiare,
- Mungesa e stafit, numri i vogël i inspektorëve, , objektet me shkallë të lartë të rrezikshmërisë mungesa e inspektorëve profesional për këtë lëmi),
- Mungesa e automjeteve dhe pajisjeve teknologjike për

TË HYRAT NGA DREJTORIA PËR INSPEKTIVE

Pranime teknike të objekteve	9,635.00 €
Gjoba mandatore	3,085.00 €
Mallra të asgjësuar	-----
Pranime teknike komunikacioni	170.00 €
Totali i të hyrave	12.890.00 €

Gjeodezi Kadastër dhe Pronë

Gjatë periudhës 01.01.2025-30.06.2025, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

Nr. Rend.	LENDET E ARRITURA Janar- qershor 2025	Gjithsejtë
1.	KERKESAT E PRANUARA	3813
2	AKTVENDIME PER BARTJE	712
3.	AKT. PER KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRA.	155
4.	AKTVENDIME PER REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	101
5.	AKTVENDIME PER CREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	37
6.	VERTETIME-CERTIFIKATA	150
7.	NDARJE, BASHKIM I PARCELAVE, KOORDINATA	388
8.	INQIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	17
9.	Uzurpimet	//
10.	KOPJE TE PLANIT	450
11.	LISTA POSEDUESE	1750
12.	KERKESA ZYRTARE TE NDRYSHME	78
13.	Shpronësime	//
14.	LENDET NE PROCEDURE	42
15	Kërkesa tjera(identifikim, dalje ne teren, ankesa etj).	101

Në periudhën Janar-qershor 2025 kemi pranuar 712 kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve ky shërbim ka marr 670 aktvendime me të cilat janë miratuar apo refuzuar kërkesat e palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje janë edhe 42 kërkesa (lëndë).

Kemi pranuar nga ana e palëve – qytetarëve 155 kërkesa për korrigjimin e gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave, të cilat gabime kanë pasuar nga e kaluara. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë aprovuar 155 kërkesa të tilla ndërsa 10 prej tyre janë refuzuar. Këto kërkesa në lidhje me korrigjimin e emrit apo të mbiemrit bëhen pa pagesë. Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe prone në periudhën janar-qershor 2025 ka pranuar 101 kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe 37 kërkesa për çregjistrimin e hipotekave, të paraqitura nga personat fizik dhe juridik.

Pas zhvillimit të procedurës kemi marr 101 aktvendime për regjistrimin e hipotekave dhe 37 aktvendime për çregjistrimin e hipotekave.

Për nevoja të aplikuasve të ndihmës sociale janë lëshuar 180 certifikata që nuk posedojnë pasuri të paluajtshme si dhe 155 certifikata pronësore. Pasi që përfituesit e ndihmës sociale janë të liruar nga pagesa për shërbimet të tilla nga këto shërbime nuk janë inkasuar mjete financiare.

Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar 1561 certifikata pronësore dhe 410 kopje të planit.

Pranë kësaj drejtorie gjatë kësaj periudhe kemi aprovuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

MENAXHIMI I PRONES KOMUNALE

Bazuar në nenin 22, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të

Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme, paraqesim Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore dhe lokaleve afariste në pronësi të komunës për periudhën 01.01.2025-30.06. 2025.

Për momentin në menaxhim kemi 25 Kontrata për dhënien në shfrytëzim të tokave bujqësore në pronësi të komunës dhe 28 Kontrata për dhënien me qira të lokaleve afariste në pronësi të komunës.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë 4 këmbime të pronave, janë proceduar 2 prona për shpronësim, janë lëshuar disa vendime për lirim të pronës së uzurpuar, janë lëshuar 14 njoftime për borgjet e pa shlyera të qirasë. Gjatë periudhës janar-qershor 2025 janë lidhur 14 kontrata të reja për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Vlera e inkasuar nga pronat komunale të dhëna në shfrytëzim për periudhën 01.01.2025 deri më 30.06.2025 arrin shumën prej 12.549.34€.

PUNET E KRYERA PER NEVOJA TE KOMUNES

Gjatë periudhës raportuese zyrtarët e drejtorisë kanë kryer punë të ndryshme për nevojat të Komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.)

Për kundër punëve dhe detyrave të punës të kryera në gjashtë mujin e parë të këtij viti, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ballafaqohet me një sërë problemesh të natyrës objektive dhe subjektive si: Mungesa e Elaborateve kadastrale, të cilat janë plaçkitur nga okupatori serb në vitin 1999, Problemet e trashëguara të natyrës pasurore-juridike si uzurpimet, kontestet e bartura nga komasacioni etj.

Mbrojtje dhe Shpëtim

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 në DMSH ka pasur angazhime të rregullta por edhe raste emergjente veçanërisht me vërshime ku edhe kemi intervenuar me kompaninë e kontraktuar për angazhim në situata emergjente në terren për eliminimin e disa pikave kritike .

Kemi pasur takime me pjesëtarë të FSK-së, AME-së me Policinë e Kosovës - Stacioni në Vushtrri, KFOR-in , Kryqin e Kuq në Vushtrri, QOR 112.

Në periudhën Kohore Janar-Qershor 2024 në Komunën e Vushtrrisë karakterizohet me fatkeqësi të vogla natyrore dhe fatkeqësi tjera në krahasim me vitet paraprake. Megjithatë edhe në këtë periudhë ka pasë fatkeqësi të cilat edhe kanë shkaktuar dëme të konsideruara materiale.

Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera , në bazë të kërkesave të qytetarëve kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë vlerësimin e dëmeve , të cilat paraqiten në këtë raport 6 mujin

Dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, janar-qershor 2025

Ky raport pasqyron dëmet e shkaktuara në sektorin e ekonomisë dhe bujqësisë në Komunën e Vushtrrisë gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2025. Të dhënat janë mbledhur në bazë të kërkesave zyrtare për kompensim të dëmeve të parashtruara nga qytetarët e komunës, si dhe nga vlerësimet e bëra nga Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera në nivel lokal.

1. Dëmet në Ekonomi,

Janar 2025 - Vlera e dëmit të vlerësuar: 2,100.00 €

Mars 2025 - Vlera e dëmit të vlerësuar: 6,374.00

Qershor 2025 - Vlera e dëmit të vlerësuar është 3,768.00 €.

Gjithsej vlera e dëmeve në ekonomi për periudhën janar - qershor 2025: 12,242.00 €.

2. Dëmet në Bujqësi, Dëmet në sektorin e bujqësisë janë shkaktuar kryesisht nga kushte të pafavorshme meteorologjike, përfshirë erërat e forta më 13 dhe 14 mars 2025, si dhe nga ulja e temperaturave më 20.05.2025, që kanë dëmtuar sera dhe pemishte me dredhëza.

Mars 2025 - Dëmi i vlerësuar: 1,221.00 €

Maj 2025 - Dëmi i vlerësuar: 522.66 €

Gjithsej vlera e dëmeve në bujqësi për periudhën Janar–Qershor 2025: 1,743.66 €

Intervenimet me makineri për raste emergjente dhe Parandaluese

Gjatë kësaj periudhe, nga situata e krijuar në teren është paraqitë nevoja për intervenim me makineri të ndryshme me ç'rast Kompaninë Kontraktuese N.N.P „HYSNIA” kemi angazhuar në vende të ndryshme për intervenime emergjente dhe parandaluese.

Vlera e përgjithshme e shpenzimeve për intervenime emergjente dhe parandaluese për këtë periudhë 6 mujore ka qenë: 29.993.50 euro.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Ambjentit dhe Planifikimit Hapsinor, kemi Pastruar dhe Zgjerruar lumin e sllakovcit në gjatësi prej 13 km nga fsh. Maxhunaj deri në fsh. Ceceli.

Prioritetet e DMSH-së për situatat e krijuara:

- Ndihma dhe shpëtimi i njerëzve;
- Hapja e rrugëve dhe kanaleve nëpër vende ku ka mbeturina të ndryshme e që e kanë bllokuar derdhjen e ujit me qëllim të parandalimit të rrezikut.
- Debllokimi i lëshesave dhe kanalizimeve në raste të vërshimeve apo mbylljeve nga shkaktarë të ndryshëm.
- Evitimi i ujit prej shtëpive që kanë qenë të rrezikuara nga vërshimet;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për banorët të cilëve iu është ndotur uji i pijes;
- Vizita mjekësore për banorët e izoluar në rast nevojë;
- Hapja e rrugëve si pasojë e rrëshqitjes së dheut.

Problemet dhe vështirësitë:

- Mungesa e Stafit
- Kërkesat e mëdha dhe të njëpasnjëshme të qytetarëve për intervenim.
- Mosbindja e disa qytetarëve për të vepruar në terren konform planit për veprim emergjent.
- Mungesa e mjeteve adekuate për punë.
- Mungesa e veshmbathjes mbrojtëse dhe dalluese për zyrtarët e DMSH-së.

AKTIVITETET E NJPZSH-së GJATË PERIUDHËS JANAR-QERSHOR 2025

Gjendja e përgjithshme e mbrojtjes – parandalimit nga zjarri në K.K. –Vushtrri.

Sa i përket gjendjes së përgjithshme të sigurisë mbrojtjes nga zjarri në rajonin e komunës së Vushtrrisë me rrethinë në krahasim me gjashtë mujorin e vitin e kaluar (2024), mund të thuhet se gjatë këtij gjashtë mujori ka pasur më shumë raste e veçanërisht atyre të zjarreve (fushore- malore) zjarre të shkaktuara nga temperaturat dhe pakujdesia e faktorit njeri.

Gjendja e përgjithshme e mbrojtjes (parandalimit) nga zjarri duke marr parasysh (objektet vitale) edhe pompat- stacionet për furnizim të qytetareve me derivate dhe gas pothuaj se është e volitshme, pasi që këta

i (kryejnë) eliminojnë masat kryesore të sigurisë nga zjarri dhe e marrin shumë serioz situatën ku 70% prej tyre i kanë të evituara mangësitë në objekte.

Posedojnë:

- aparatet për fikjen fillestare të zjarrit,
- atestet e rrymës elektrike (çdo vit e ateston një here),
- punëtorët e aftësuar për t'i përdorur aparatet kundër zjarrit,
- shkallet për evakuim,
- hyrje –daljet emergjente, etj.

Gjendja në objekte publike është e volitshme.

Është punuar mjaft në ngritjen e vetëdijes qytetare duke i njoftuar qytetarët me rrezikun i cili mund t'iu kanoset nga pakujdesia apo mosdija e tyre Në aspektin e parandalimi nga zjarrit është arritur sukses pasi që numri i zjarreve në objekte ndërtimore tani është në rënie të dukshme.

INTERVENIMET SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2025														
	LIOJI I INTERVENIMIT	Jan	Shku	Mar s	Pril l	Ma j	Qers h	Korr	Gush	Shta	Tet	Nënt	Dhje	GITHËSEJT Ë
1	ZJARRË	10	14	62	20	15	69							190
2	INTERVENIME TEKNIKE	3	2	5	11	8	8							37
3	SHËRBIME	18	20	18	24	24	46							150
4	AKSIDENTE KOMUNIKACIONI		1		1									2
5	VËRSHIME													
6	ALARME TË RREJSHME	3		1	1		1							6
	Gjithësejtë:	34	37	86	57	47	124							385
1. zjarre në : OBJEKTE NDËRTIMORE														
1.1	Banesa – shtëpi			1			1							2
1.2	Objekte ndihmëse	1		1		2	4							8
1.3	Plevica - shtalla													
1.4	Objekte kolektive (banesa)													0
1.5	Oxhaqe	1												1
1.6	Të tjera			1	1	1								3
	Gjithësejtë:	2	0	3	1	3	5							14
4. zjarre në : SIPËRFAQE TË HAPURA														
4.1	Mal			28	2		9							39
4.2	Sipërfaqja e djegur (hektar)			59.8	10		10.1							

4.3	Bari i thatë		4	23	3		23							53
4.4	Sipërfaqja e djegur (hektar)		1.3	9	7		8							
4.5	Sipërfaqe bujqësore			1			2							3
4.6	Sipërfaqja e djegur (hektar)			1.5			0.3							
4.7	Të tjera	4	5	6	8	10	26							59
	Gjithësejtë:	4	9	58	13	10	60							154
Pjesëmarrja e zjarrfikësve:														
	Zjarrfikësa aktiv	63	62	193	115	91	298							822
	Zjarrfikësa vullnetar													0
	Komandues - 1-K1			7	3	2	11							23
	Sulmues - 1-S1	7	2	10	6	7	24							56
	Sulmues - 1-S2		1	9	3	1	7							21
	Sulmues - 1-S3	2		1	1	2	7							13
	Tanker - 1-T1	18	20	17	25	23	52							155
	Platforma				1	1	1							3
	Auto.teknik AKRR													0
	Malor - 1-M1	6	14	43	18	11	48							140

Ky Raport paraqet punët që janë kryer nga ekzekutivi i komunës në këtë gjashtëmuor. Nga muaji korrik deri në ditën kur po paraqitet ky raport janë kryer edhe punë tjera të shumta, të cilat do të përfshihen në raportin vjetor 2025.

